


JUBILEU I NJË APOSTULLI



(Në 200 vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës)



- Hasan Ukëhaxhaj -



HYRJE

Në rrugëtimin e gjatë nëpër tërthoret e historisë, nëpër kataraktet e saj të thepisura, populli shqiptar nxori nga gjiri i vet figura të shquara, të cilat me pushkë e me pendë, ia hapën shtegun për t'i kapërcyer ato. Prandaj, ata u bënë prijës, krijuan epoka, përvijuan kahet e t'ardhmes kombëtare, duke u bërë gurrë frymëzimi përmasash mitike për brezat që do të vinin nëpër dekada e shekuj.

Pa u ndalur n'analet e së kaluarës më të lashtë, po theksojmë se një shekull i tërë, në saje të një të katërtës së tij të papërsëritshme, ka

vetëm një emër - atë të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut - figura më e lavdishme, bashkë me epokën e tij, në historinë shqiptare. Në istikamet e asaj epoke, tërthorazi, mbrohej edhe Europa; prandaj Kryeheroi ynë u lauria edhe si një hero i përmasave të saj. Këtë e dëshmon ajo vistër kronistësh, historianësh e shkrimtarësh, të cilët, me veprat e tyre, i ngritën monumente lavdie. Ndonjë shkarravinë e hershme apo edhe e ditëve tona, përgjigjet i kanë marrë. Prandaj, nëpër shkallët e katër të tjerëve, ai u shndërrua në legjendë, edhe në gurrë frymzimi që shpërtheu si llavë vullkani në zemrat dhe mendjet e pasardhësve të tij, të cilët, me pushkë e me pendë, shembëllyeshëm Motit të Madh, hapën një Epokë të re e të lavdishme gjithashtu, e cila në historinë tonë është pagëzuar si periudha e RILINDJES KOMBËTARE.

Përkundër të parës, kjo e dyta nisi me armët e mendjes, duke u mbështetur edhe me ato të krahut. Siç dihet, në të kaluarën tonë nuk mungojnë kthesa të karakterit kulturor, politik e ushtarak që rezultuan nga rrethanat korrespondente që u zhvilluan jashtë trojeve tona. Por, pa u ndalur këtu në asnjë rast, nuk mund të mos theksojmë se hapat tanë të ngadalshëm, jo gjithmonë rezultuan nga baticat dhe zbaticat e jashtëme. Përkundrazi, ato shpesh na detyruan të nxitojmë. Megjithatë, dihet katërçipërisht, për ata që duan ta dinë se vorbulla e tyre do të na kapërdinte, jo vetëm njëherë, sikur të mos shndërroheshim ne vetë në diga të pathyeshme.

Meqë kjo temë s'e ka vendin të trajtohet këtu më gjatë, po u kthehem rreshtave të kryeradhës së mësipërme. Pas „nënshtrimit“ t'Europës Perëndimore, Romantizmi, si shkollë letrare, vërshoi edhe në viset e tjera. Siç dihet, atë, e karakterizojnë një varg tiparësh, ndër të cilat është edhe ideja e lirisë. Shkrimtarët që u përkisnin popujve, të cilët ende rënkonin nën kthetrat e këti apo atij pushtuesi, ideja e lirisë ishte „alfa dhe omega“ e veprave të tyre. Prandaj, ideja e lirisë ishte tharmi i çdo vepre të rilindasve tanë, pavarësisht zhanrit të tyre. Ajo rrezatoi „duke filluar që nga Alfabeti e gjer te mbrujtja e një gjuhe letrare dhe të formimi i një literature të vet, në lëmë politike krijimi i një shteti. Kjo vepër njëkohësisht letrare e kombëtare përqendrohet në shek. XIX të dy burra: Girolamo, de Rada në Itali ..., Naim Frashëri në vendin mëmë...“ (E. Çabej në „Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, 2006 f. 98). Dy emrat e përmendur në rreshtat e mësipërm emblemantikë janë dy kulmet e romantizmit në letërsinë shqipe.

Po, të parit mos i takon edhe ndonjë „epitet“ tjetër? Po: „...lindi dhe u zhvillua në Shqipëri edhe ideologjia kombëtare. Shprehësit e parë më të shquar të ideve të reja u bënë Naum Veqilharqi dhe Jeronim de Rada“ (Historia e popullit shqiptar II Rilindja Kombëtare, Tiranë, 2002 f. 98).

Pra, poeti i madh ishte njëkohësisht edhe njëri nga ideologët e parë të Lëvizjes sonë Kombëtare. Gjykimin e sipërm e gjejmë të mbrujtur në thelb edhe në vëzhgimet e disa studiuesëve të tjerë të shquar, ndër të cilët po citoj vetëm edhe një, për t'mos u zgjatur që në fillim me referenca: „Romantizmi shqiptar është një nga ato lëvizje letrare... që i priu, mund të thuhet plotë gojën me punën e tij të jashtëzakonshme në fushën e kulturës e veçanërisht të letërsisë, me ideologjinë e tij Lëvizjes Kombëtare shqiptare“ (Dh. S. Sh “Segoni, De Rada... Serembe... Noli..., Tiranë, 1987. f. 178/79). Prandaj, mendimi i studiuesit të zellshëm, i njërit nga deradianët më të merituar Jup Kastratit, se Naumi, De Rada, Kamarda e ndonjë tjetër janë „pararëndësit e Rilindjes sonë Kombëtare“ duket krejt i paqëndrueshëm (Histori e gramatologjisë shqiptare 1635-1944, Rilindja, Prishtinë, 1980 f. 84).

Para se t'i çasem veprimtarisë së jashtëzakonshme të arbreshit të lavdishëm e shoh të arsyeshme që ta „rezimoi“ veprën e Naumit, e cila mund të emërtohet, pa kurrfarë ngurimi, si i pari traktat, i pari manifest politik e kulturor i Rilindjes Kombëtare. Cilët janë „kapitujt e veprës së tij? Dy Ëvetarët, apo dy abetaret e para të gjuhës shqipe, që mund të konsiderohen si djepi i të tjerave bashkë me alfabetin krejtësisht të ri, të cilin e hartoi vet; Parathënia e të dytit Ëvetar me Qarkoren e famshme dhe letra e njohur, drejtuar nipit të vet grekoman. Gjurmuesit e veprimtarisë së tij kanë shprehur mendimin se Naumi mund të ketë shkruar edhe një gramatikë të gjuhës shqipe. Megjithatë tekstin nuk arriti ta gjejë asnjëri prej tyre. Pra, vepër e paktë në vëllim, me tematikë të larmishme, po e një rëndësie kapitale për të ardhmen e kulturës dhe të Kombit në përgjithësi. Naumi i tërboi armiqtë e kombit shqiptar me veprimtarinë e vet, prandaj edhe ata ia morën jetën në mënyrën më tinzare.

Do të ndalem pak vetëm rreth alfabetit me të cilin Naumi i shkroi veprat e veta, duke iu referuar siç thot vetë ai mikut të tij iluministit rumun Radulesku: „Ky alfabet ka më shumë mundësi të pajtojë mendimet që i ndajnë banorët e Shqipërisë... përpjekjet e z. Naum

mund të konsiderohen te ky popull si një simbol kombësie, rreth të cilit mund të mblidhen të gjitha pjesët e shpërndara prej aq shekujsh dhe të bëjnë një të tërë...“ (Shih shënimin nr. 10: Mahir Domi - Mbi jehonën e botimit të abetarit shqip... në veprën e R. Qoses Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi II. Rilindja, Prishtinë, 1984. f. 23). Çdo koment tjetër për synimet e atij atdhetari të rrallë do t'ishte i tepërt. Parathënien e të dytit bashkë me qarkoren dhe letra e njohur drejtuar nipit të tij grekoman përbëjnë një vepër kapitale për fillet e Rilindjes Kombëtare.

Siç po shihet, e paktë në vëllim, e larmishme në tematikë e përmbajtje madje edhe në zhanër po me një bosht të vetëm ideor – tërë atë që ngërthen togfjalëshi çështja kombëtare, vepra e Veqilharqit është një nga margaritarët më të çmueshëm të historisë dhe kulturës shqiptare. Ajo dhe të tjerat e këtyre përmasave ua kanë bërë dhe do tua bëjnë gjithmonë gjyqin dhe ua kanë shqiptuar dënimin: përgjithmonë në „Ferrin“ e Dantes të gjithë atyre që u përpoqën dhe përpiqën t'i rrenojnë fitoret e arritura me pushkë e pendë, që përpiqen ta përçajjnë kombin nga secili aspekt qoftë.

Se me çfarë çmimi e pagoi Naumi përkushtimin e vet prej atdhetari u tha më lart. Shumë e kushtueshme, por nuk ishte e para as e mbrama, sepse në altarin e atdheut kishin rënë e do të binin gjithmonë ata që lirinë e vendit e shihnin më të shtrenjtë se jetën. Por kjo bashkë me atë të vitit 1919 përbëjnë një ko incidencë nga më të veçantat në mesin e shumë të tjerave që e përshkojnë historinë dhe kulturën tonë kombëtare. Pra, derisa ideologu i parë i Rilindjes helmohet në Stamboll nga shovenistët grekë, „përmbaruesi“ i asaj epoke të ndritur, arkitekti i shpalljes së Pavarësisë dhe themeluesi i shtetit shqiptar, I. Qemali helmohet në Perugjia t'Italisë në rrugëtim e sipër për t'i dalë zot atdheut (Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985 f. 1161; „I. Qemali“ Monografi, Koli Xoxi, Tiranë 1983 f. 399).

Po vepra e tij, ndonjë „kapitull“ i saj mos u ndëshkua? Po: Ëvetari i dytë e pësoi gati si autori. Fati i tij shëmbëllen me atë të librit të parë të shkruar në gjuhën shqipe që e kemi në dorë deri tash. Prandaj, me pak rreshta po e përshkruaj edhe ko incidencën e mësipërme. Siç dihet, vepra e Buzukut, pas një jete të shkurtër nëpër duart e lexuesve që vërtetohet nga disa anëshkrime të tyre nëpër faqet e saj, për një kohë të gjatë humbi, jo më pak se tre shekuj. U gjet pikërisht në vitin e themelimit të Normales së Elbasanit nga Pal Skiroi. Por për të arritur

deri këtu ndihmesa të çmushme dhanë disa admirues të librit shqip, ndër të cilët, edhe Gjon Nikollë Kazazi (E. Çabej: Meshari i Gjon Buzukut, Botim kritik, Tiranë, 1968. f. 7).



Edhe Ëvetarit të dytë, pas disa dekadave i humbën gjurmët në ato përmasa sa që kërkuesi më i famshëm i librit shqip Profesor Dh. S. Shuteriqi „dorëzohet“ duke pohuar se mund të jetë djegur me 1915 në shtëpinë e pionierit rilindas, në Fier, të cilës armiq të patën vënë zjarrin (Dh. S. Shuteriqi, cituar nga R. Qosja në „Semantika e ndryshimeve historiko-letrare“ Prishtinë, 2009 f.182). Po derisa, Meshari u gjet i cunguar, pa 16 faqet e para, që do të thotë përveç të tjerave pa titullin dhe vendin e botimit, parathënia e Ëvetarit njihej. Ajo ishte e botuar në revistën „Kalendari Kombjar“. Megithëse, siç u tha më lart, vepra konsiderohej e humbur përgjithmonë, kërkimet nuk u ndërprejnë dhe, më në fund nuk shkuan kot: Evëtari u gjet në Athinë nga historiani Shkëlzen Raça me 1982. Lexuesi e ka të plotë në veprën e sapo cituar të R. Qoses.

I

Duke iu kthyer tani titanit arbëresh, dua të theksoj se pikëpamja e shumë dijetarëve që personalitet historike dhe kulturore së pari duhet

të vlerësohen në raport me rrethanat e kohës, në të cilat kjo apo ajo figurë ka vepruar dhe vetëm pastaj në çfarë përmasash ka arritur të komunikojë me t'ardhmen është verifikuar si e mbështetur. Mund të thuhet kështu sepse një komunikim i denjë me të tashmen, qoftë edhe përmes të kaluarës nuk mund të mos shtegtojë edhe në të ardhmen. Po dua ta ilustroi këtë me një shembull konvencional ta quajmë nga fusha e gramatikës së gjuhës sonë, respektivisht e morfologjisë: Format gramatikore të foljes të kohës së tashme, në një mënyrë a në një tjetër, janë pjesë përbërëse të së shkuarës dhe të ardhmes. Edhe pikëpamja tjetër se jo më pak e rëndësishme se ajo që e bënë njeriu, është edhe mënyra se si e bën, mund të ilustrohet dhe të mbështetet me një shembull tjetër si ky i mësipërmi: Folja në gjuhën shqipe i ka gjashtë mënyra, përmes të cilave shprehet kuptimi dhe funksioni në strukturën e fjalisë (Gramatika e gjuhës shqipe, vëll. I Morfologjia, Tiranë, 1995 f. 272 - 273). Shembujt e mësipërm janë pasqyrë e ligjësave të të shprehurit të mendimeve në çdo gjuhë.

Tani, në ç'përmasa iu përgjegj De Rada rrethanave, në të cilat ndodhej populli shqiptar në tre çerekët e shek XIX? Përgjigjja: konstatimi, pa asnjë ekuivok i profesor Çabejt që u citua më lart. T'i shohim degët mahnitëse të lisit deradian: Gjuhëtar, poet, historian, folklorist,estet, publicist,mësues e veprimtar politik. Ndonjë segment tjetër mund të përftohet edhe më poshtë. Në këtë punim, kjo veprimtari e jashtëzakonshme do të vështrohet vetëm në përmasat e një panorame, në të cilën nuk do të mungojnë as mendimet e shkrimtarëve dhe studiuesvetë shquar, qofshin ata shqipatrë apo të huaj. Një çështje tjetër që duhet theksuar këtu është se De Rada në disa nga fushat e përmendura më lart, siç është çështja e alfabetit, mbledhja e këngëve popullore, fillet e krijimtarisë poetike e ndonjë tjetër punoi paralelisht me dekada të tëra. Kjo provë dëshmon se ai i përgjigjej flakë për flakë Epokës së Rilindjes, sfidave të shumta të cilat ajo duhej t'i përballonte. Ato nuk prisnin në radhë. Për këtë arsye disa studiues, më duket me të drejt, veprimtarinë e De Radës e kanë analizuar duke e zbatuar parimin tematik, ndonëse edhe ai kronologjik është i pashmangshëm. 1.Prandaj, edhe ne po fillojmë me De Radën gjuhëtar. Në këtë fushë përveç çështjes së alfabetit, arbëreshi i shquar trajtoi edhe këto çështje: Prejardhjen e gjuhës shqipe, gramatikën e saj - fonetikë, morfologji e sintaksë, aspekte të ndryshme në fushën e leksiokografisë, toponimisë e ndonjë tjetër.

A) ALFABETI

Tre shekuj pas botimit të Mesharit, gjuha shqipe shkruhej me disa alfabete. Ajo gjendje kishte përmasat e një gangrene që e gërryente identitetin tonë kombëtar. Prandaj edhe De Rada, si Naumi pak para tij, e hartoi alfabetin e vet me shpresë se do t'i pranohej nga ata që shkruanin shqipen; pra nga shqiptarët në radhë të parë. Me atë alfabet e botoi edhe poemen e tij të parë „Këngët e Milosaos“. Kërkues i pamëshirshëm ndaj vetvetes dhe, në këtë aspekt nga më të rralltë në letrat shqipe, De Rada e përpunoi vazhdimisht në harkun kohor prej mëse gjashtë dekadash. Puna e tij rezultoi me këto variante: 1834 - 36 - '47 - 66 - '71 - '73 dhe '83 - '94 (Tomor Osmani: „Udha e shkronjave shqipe“ Shkodër, 1999 f. 320-36 - shih tabelat; Jup Kastrati „Studime për De Raden“ në New York, 2003 f. 63-67). Duhet thënë këtu se në variantin e fundit De Rada arriti t'i mënjanojë të gjitha shkronjat e alfabetit grek.

Puna e tij në këtë fushë është vlerësuar nga studiuesit si një nga përpjekjet më të rëndësishme në kuadrin e gjithë synimeve të të gjithë rilindasve për ta zgjidhur çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Ndërkaq, duhet të theksojmë se poeti arbëresh edhe pas vitit 1894 opinionit shkencor dhe jo vetëm atij, ia bëri të njohura mendimet e veta edhe në rrafshin teorik. (T. O. Vep. E cit. f. 334; J.K. Vep. E cit. f. 65); ndonëse disa prej tyre ishin të paqëndrueshme. De Rada nuk e pranoi propozimin e Vëllezërve Frashëri për ta bërë të vetin alfabetin e shoqërisë „Drita“ për arsye se, sipas tij, kishte disa të meta të pakapërcyeshme. Shikuar nga një periudhë e mëvonshme, pavarësisht nga mungesat e atij alfabeti De Rada do ta bënte një hap të madh në rrafshin kombëtar sikur t'i thoshte Po propozimit të frashrëllinjëve. Megjithatë, përmes një mendimi që ngërthente përveç propozimit edhe shpresën se çështja e alfabetit do të zgjidhet „... kur drejtuesit e „Dritës“ së Stambollit, kryesia e shoqërisë së Bukureshtit dhe ne bashkë do të këmbëjmë mendime për të shikuar se cilat shkronja mund të jenë të nevojshme të përdorën për një njësim të gjuhës sonë të përbashkët (T. O. Vep. E Cit. f. 336, J.K. Vep. E Cit. f. 64).

Megjithëse ai „këmbim mendimesh“, siç dihet, nuk u realizua asnjëherë, idenë e poetit të madh arbëresh se çështja e alfabetit do të zgjidhet atëherë hur shqiptarët do ta shqyrtojnë së bashku, e sëndertoi „Kongresi i Manastirit“. Prandaj, mund të thuhet se me përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm dhe me kushtimin që e dha, De Rada që dhe

mbetet njëri nga rilindësit më të shquar, të cilët në përpjekjet e tyre të përbashkëta më në fund e zgjodhën „nyjën Gordiane“ të kulturës shqiptare.

B) PREJARDHJA E GJUHËS SHQIPE

Çështja, siç dihet, përveç se më herët, ka tërhequr vëmendjen e dijetarëve europianë që nga shek. XVIII, në mesin e të cilëve atyre gjermanë u takon merita dhe nderi shkencor për kontributin e tyre të veçantë. Ata janë të parët që u shprehën se shqiptarët janë autokton në trojet ku jetojnë dhe të parët e tyre kanë qenë ilirët (Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, Rilindja, Prishtinë, 1990 f.15 - 18). Ndërkaq, në shekullin që jetoi De Rada sidomos në gjysmën e tij të dytë prejardhja e shqiptarëve dhe e gjuhës së tyre përtej interesit shkencor mori edhe një deminsion tjetër - politik. Kjo përmasë e rezultoi për arsye se n'atë periudhë shpërthyen shkëndijat e Krizës Lindore. Prandaj, për shqiptarët çështja ishte krejtësisht e karakterit kombëtar. Në ato rrethana De Rada atdhedashës i rrallë nuk mund të qëndronte indiferent ndaj asaj ere që kishte filluar të frynte. Duke e njohur në themel literaturën artistike e shkencore të periudhes antike greko-romake, ai e krijoi opinionin e vet se gjuha shqipe ishte bijë e pellazgjishtes. Nuk mund të mos përmenden këtu pararendesit e tij në këtë fushë nga radhët e arbreshëve, siç ishin Nikollë Keta e Engjëll Mashi.

Para se të vazhdoj më tutje, mendojmë se është në interesin e lexuesit që të dijë se të kaluarës kombëtare në rrafshin shkencor De Rada ia kushtoi jo më pak se 40 punime, disa prej të cilave janë të përmasave monografike. Tematika e tyre është e karakterit historik e gjuhësor. Sa për ilustrim, po i shënoj këtu ndonjë nga titujt e tyre: Hyjni Pellazge, Identiteti i Pellazgëve me shqiptarët, Dinjiteti i gjuhës shqipe, Dukuri gramatikore të gjuhës shqipe e të tjera. Kjo „kollanë“ e cila si vëllim ngërthen afër 2000 faqe filloi të shkruhet nga viti 1834 dhe vazhdoi deri në fund të jetës së tij (J.K Vep. e cit. f. 30 – 31). Tanimë është krejt e qartë se në një punim si ky, natyrën e të cilit e ceka më sipër, sa shkurt na duhet t'i biem kësaj çështjeje. Megjithatë, do të përpiqemi mundësisht për ta pasqyruar qoftë edhe në mënyrëm më koncize që të jetë e mundur kontributin e De Radës në këtë fushë. Autori i këtyre punimeve e mbështeste mendimin e vet kryesisht në emrat e hyjnive si Posejdoni, Zeusi, Nemesi, Afërdita etj. Po edhe në disa emra vendesh,

të cilët i shpjegon me anë të shqipes, respektivisht nga pararendesja e saj, sipas tij, pellazgjishtja.

Ndërkaq, Përmasë europiane kësaj teze i dha dijetari gjerman Hahni, i cili në veprën „Studime shqiptare“, e botuar më 1854 në Vjenë, në tezën e katërt vuri shenjën e barazimit midis ilirëve dhe pellazgëve (Autoktonia ... f. 89). Ndonëse De Rada nuk e ndjente veten inferior në raport me emrat e njohur të gjuhësisë europiane, mendimi i dijetarit gjerman nuk mund të mos e ketë nxitur për t'i mbrojtur më me vendosmëri pikëpamjet e veta. Kjo shihet edhe në letërkëmbimin që pati me albanologun më të shquar të kohës, Gustav Majerin. Ka edhe shumë çka për t'u thënë në këtë aspekt, por do të kapërcehim së tepërmi caqet e natyrës së këtij punimi. Megjithatë do t'u kthehemi shkurtimisht aty ku e kanë vendin. Prandaj këtu duhet të theksoj se flamuri i lashtësisë së shqiptarëve dhe i autoktonisë së tyre në trojet ku jetonin e që e ngriti De Rada shumë më denjësisht se paraardhësit e tij arbëreshë, valoi në duart e shumë personaliteteve të Rilindjes, ndër të cilët nuk mund të kapërcehen dy majat e saj emblematike që i rrinë në të dy krahët poetit arbëresh: Përveçse tjetërkund, Naimi e shkroi edhe poezinë e njohur „Pellazgët- shqiptarët“, e Samiu në Manifestin e asaj epoke „Shqipëria...“ shkroi: „më të vjetërtë prindërt' tanë bota i quajnë pelazgë, fjal' e mbeturë nga prindërit tanë më të pastajmë... (Shqipëria Çka qenë... në Vepra II, Tiranë 1988 f. 20)

Me vëzhgimet në fushën e toponimisë e onomastikës De Rada e begaton tezën e vet për lashtësinë e gjuhës shqipe si bijë e pellazgjishtës duke i analizuar një vistër emrash, ndër të cilët po i përmendim këtu sa për ilustrim: Dyrrachium, Emathia, Pelazgoi, Tesali e shumë të tjerë. Duhet thënë se ato vëzhgime janë pjesë e punimeve të shumta të karakterit gjuhësor e historik, të botuara gjatë jetës së tij. Po i përmendim këtu „mbi pellazgët dhe shqiptarët“, „shqiptarë dhe grekë“. Ato vëzhgime nuk mund të mos kishin edhe karakter etimologjik. Prandaj, pavarësisht nga fakti se sa u qëndronin interpretimet e De Radës kritereve të kësaj fushe, ato janë vlerësuar si kontribute, përveç të tjerave, edhe për arsye se disa prej tyre janë çmuar se janë afër analizës së mirëfilltë shkencore.

Duke e mbrojtur me këmbëngulje lashtësinë e kombit dhe të gjuhës arbëreshi i madh synonte ngritjen e vetëdijës kombëtare të masës së gjerë, e cila ishte në këtë aspekt ende largë cakut që e kërkonin rrethanat e kohës. Në anën tjetër kundërshtoheshin padrejtësitë që

kishin filluar t'u bëheshin shqiptarëve në gjysmën e dytë të shek. XIX.

C) DE RADA FONETIKAN DHE GRAMATOLOG

Atdhetar krejt i jashtëzakonshëm, madje i papërseritshëm në shumë aspekte, kur të peshohen rrethanat në të cilat jetoi dëshmon fakti se poeti i madh i trajtoi me përkushtim të rrallë të gjitha çështjet që kishin të bënin me kombin shqiptar dhe kulturën e tij. Përveç gramatikës që konsiderohet si „e para e kësaj fare“, që u botua nga një shqiptar (J. K. „studime për De Radën“ f. 69), çështjet e kësaj fushe autori i trajtoi edhe në disa punime tjera, titujt e të cilave po i kapërcejmë. Përveç se për alfabetin, në vështrimet rreth tipareve fonetike të gjuhës shqipe, autori trajton sistemin vokalik të cilit ia njuh gjashtë zanore, por ia shton edhe të shtaten - ë-në , që sipas tij është e pazëshme e shurdhët. Duhet të theksojmë këtu se De Rada është i pari në gjuhësinë shqiptare që këtë tingull - fonemë e trajtoi në një vështrim të veçantë, ai është i pari gjithashtu që e përdori metoden statistikore. Përveç theksit e diftongjeve, ai e trajtoi edhe kuantitetin e zanoreve të theksuara, njëra ndër dukuritë më të ndërlikuara në fushën e vokalizmit të gjuhës shqipe (shih për të gjitha këto J. K. Vep e cit. F 73 - 4). Ndërkaq, bashkëtingëlloret, në kornizën e sistemit kosonantik, përveç të tjerave veçori i ka ndarë në këto grupe: Buzore, grykore, dhëmbore, e këto të fundit në të aspiruara e fishkëlluese.

Shumicën e faqeve të gramatikës autori ia kushtoi materjes që i përket morfologjisë. Aty janë trajtuar të gjitha pjesët e ligjeratës nga emri deri te pasthirrma, të ndara në dy grupe ashtu siç janë edhe tash – të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Edhe këtu nuk kemi rrugë tjetër përveç se t'i biem sa më shkurt: Emrit ia njuh të gjitha kategoritë gramatikore, të cilat i analizon në ato përmasa që atij i dukeshin të domosdoshme. Këtu duhet theksuar se asnjësin De Rada ia njuh gjuhës shqipe, çështje kjo rrth së cilës gjuhëtarë shqiptarë e të huaj patën mendime të ndryshme. De Rada me Kamardën para tij bashkë me ndonjë studiues tjetër të huaj ia njihnin shqipes gjininë asnjëse, përkundër disa të tjerëve, ndër të cilët edhe themeluesi i gjuhësisë krahasimtare F. Bopi ia mohonin (J.K. Vep e cit. f.77).

Edhe përemrat, mbiemrat e numërorët i ka trajtuar në përmasa relativisht objektive; ndërkaq sistemi foljor ia kapërdiu shumicën e faqeve të morfologjisë, gjë që është krejtësisht e kuptueshme. De Rada ia njuh foljes të tri diatezat, tri kohët, por vetëm katër mënyrat: dëftore, urdhërore, lidhoren, dëshiroren. Duke e kapërcyer zgjedhimin

e foljeve, po theksojmë se pjesët e pandryshueshme të ligjeratës i ka shtjelluar më shkurtimisht me përjashtim të ndajfoljeve, të cilat i ka ndarë në nëntë grupe.

Vepra e De Radës nuk mund t'ishte pa të meta, prandaj iu bënë edhe disa vërejtje, shumica e të cilave qëndronin. Megjithatë, gramatika u çmua lart dhe u mirëprit në opinionin shkencor të kohës. Për veprën u interesuan përveç Samiut e Kamardës edhe V. Dorsa, P. Kjara e arbëreshë të tjerë bashkë me dijetarë që i përkisnin çerthullit të gjuhësisë europiane si Majeri, Shuhardi, Mikloshiqi etj.

Por, siç është thënë mësipër e nuk mund të mos thuhet edhe më poshtë, De Rada si kërkues i pamëshirshëm ndaj vetvetes, nuk e nderpreu përkushtimin në këtë fushë me veprën veçoritë kryesore të së cilës i theksuam më lart. Prandaj, Pas një çerek shekulli, kur vetë ishte 80 vjeçar e botoi veprën me titull „Fonetikë dhe gramatikë e gjuhës shqipe“. Më duket krejt e paarsyeshme që t'i çasem monumentit të dytë deradian në këtë fushë, përmes një përshkrimi sado i shkurtër qoftë ai. Por duhet thënë pa ngurim se të gjitha çështjet janë shtjelluar më gjerësisht dhe më thellësisht se në veprën e parë. Megjithatë edhe kjo veper e re e De Radës në fushën e gramatologjisë shqiptare nuk ishte pa të meta, shumica e të cilave janë krejtësisht të kuptueshme kur të kihet parasysh fakti se studimi i strukturës fonetike dhe gramatikore të shqipes, mund të thuhet se ishte ende në fazën fillestare. Prandaj, ajo që ishte arritur ishte fryt i përkushtimit të disa dijetarëve të huaj dhe shqiptarë, në mesin e të cilëve De Rada zë një vend krejt të veçantë.

Këtu nuk mund të mos theksohet se është për të ardhur keq që gjuhëtari shumë serioz prof Selaman Riza në veprën „Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore“ s'e përmend as emrin e poetit, së paku, në cilësinë e të parit shqiptar që e shkroi një gramatikë të gjuhës shqipe, për t'iu kthyer sërish pas një çerek shekulli kësaj fushe me një të re, edhe nëse s'ka qenë „plotësisht serioze për kohën përkatëse“ e cila megjithatë, siç u tha edhe më lart ajo tërhoqi vëmendjen e gjuhëtarëve të shquar që u përmendën më sipër, ndër të cilët edhe vetë Sami Frashëri: „As njëri nga parardhësit e Kristoforidhit nuk pati dozën e duhur të kualifikimit profesional (nënvizuar dy fjalët e fundit me qëllim që të mos keqkuptohemi as nga devotët e diplomës, as nga entuziastët e talentit) për t'u bërë i pari hartues plotësisht serioz për kohën përkatëse i gramatikës përshkruese të gjuhës s'onë: Këtë meritë

historiko-kulturore na mendojmë se e bashkëpjesëtojnë gati barazisht midis tyre dy autorët vendas, Konstandin Kristoforidhi dhe Sami Frashëri (Autori dhe vepra e cituar më lart. F. 6).

Ç) DE RADA LEKSIKOGRAF...

Gjuhësia shqiptare në themelin e saj e ka leksikografinë, ndërkaq gurin e parë aty e vuri Frang Bardhi me fjalorin e tij latinisht-shqip i botuar me 1635. Pas tij, gjuhëtarë të huaj e shqiptarë e begatuan këtë fushë me vepra të tilla, cilësia e të cilave varionte për arsye të ndryshme. Por vepra më e rëndësishme, e hartuar në periudhën e Rilindjes Kombëtare ishte fjalori i gjuhës shqipe i K. Kristoforidhit. Ndërkaq, „Fjalori i rapsodive“ i botuar me 1884, dëshmon për përkushtimin e De Radës që edhe nga ky kënd të bëjë përpjekje për t'i ndriçuar disa nga veçoritë thelbësore të gjuhës shqipe. Studiuesi, nga më të pasionuarit, e poliedrikut, nga më të rrallët në kulturën shqiptare, J. Kastrati thekson se vepra ishte „pak e aspak e njohur“, prandaj „për të nuk është shkruar ndonjëherë në literaturën tonë gjuhësore“. Vepër e paktë në vëllim, me jo më shumë se njëmijë fjalë, por me vlera të veçanta. Cilat janë ato? Së pari, pasi e ka „veçuar elementin vendës nga përzierjet e huaja“ (citati i vet De Radës), ka marrë guximin t'i pasqyrojë edhe në rrafshin kronologjik huazimet jo vetëm të tri greqishteve, qysh po dua t'i quaj, po edhe latine, sllave e s'po shkoj më tej. Ky këndveshtrim i të kaluarës së shqipes konsiderohet si i pari në historinë e gjuhësisë shqiptare (J. K. Vep e cit. f. 103).

De Rada edhe këtu, duke mbrojtur mendimin e vet se gjuha shqipe është bijë e pellazgjishtes, i del zot autoktonisë së popullit shqiptar, prandaj edhe e kishte të drejtën e pakontestueshme për të jetuar si komb i pavarur në trojet e veta. Rreth këtyre që sapo u thanë, studiuesi i përmendur më lart, për të qenë sa më i besueshëm para lexuesit, ka cituar disa fragmente nga vepra e De Radës. Për të njëjtat arsye po e bëë edhe unë të njëjtën punë me katër-pesë rreshta: „...shumë fjalë të tjera tingëllojnë, pastaj, qysh prej asaj kohe të largët, para se të vinin helenët, si fjalë të një gjendjeje fqinjësie dhe afrie të pellazgëve... Me qenë se helenët zunë vendin e pellazgëve e me qenë se të dy popujt mbetën të përzier, - siç janë ende- shkëmbyen shumë fjalë qysh motit, që në lashtësi“ (J. K. Vep. E cit. f.104).

„Fjalori i rapsodive“ është një vepër që me atë mori trajtash e variantesh dialektore, të cilat përbëjnë panoramën e të folmeve

arbëreshe, moshë e të cilave shtrihet nëpër shekuj paraqet interes shkencor, gati të barabartë për degët e gjuhësisë shqiptare që për lëndë studimi e kanë evoluimin e fjalës shqipe si në rrafshin fonetik e dialektor, ashtu edhe në atë morfologjik e leksikor.

D) DE RADA DHE GJUHA E NJËSUAR LETRARE

Mendimi i shprehur dekada më parë se nëse shkrimin e shqipes që zë fill në përmasa të gjëra me „Mesharin“ e Buzukut e që vijoj pa asnjë „Vakum“ deri në ditët tona, mund ta „vështrojmë si histori e gjuhës letrare shqipe, atëherë atë do ta ndanim në dy periudha të mëdha - në peridhën parakombëtare dhe në atë kombëtare“ (A. Kostallari: Mbi disa veçori strukturore... në Studime mbi leksikon I Tiranë, 1972 f. 7), është krejt i padiskutueshëm. Edhe „kufiri“ mes tyre - gjysma e parë e shekullit XIX – gjithashtu. Për hir të së vërtetës, sa u përket këtyre dy konstatimeve të sapo theksuara duhet thënë se, në vija të përgjithshme janë vënë në dukje edhe më përpara. Për këtë që u tha nuk e shoh të arsyeshme asnjë referencë. Po, i rëndësishëm është fakti se autori i cekur më sipër i ka analizuar shkencërisht, si asnjëherë më parë, veçoritë e të dy periudhave në të gjitha aspektet.

Në „pentagramin“ e Programit politik e kulturor të Lëvizjes Sonë Kombëtare që u përpunua në vazhdimësi nëpër dekadat e atij gjysmëshekulli e që u kristalizua me formimin e LSHP dhe me dokumentet që ajo i miratoj, gjuha shqipe zinte vend të rëndësishëm. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe sepse rilindasit, në radhë të parë, gjuhën e tyre amtare e shihnin, me të drejtë, si shenjën e parë të njësisë kombëtare dhe, së dyti, e dinin se pa zhvillimin e saj të gjithanshëm nuk mund t'i relizonin detyrat që ia kishin vënë vetëvetes. Prandaj, gjuha e përbashkët letrare nuk mund të mbetej jashtë përkushtimit të tyre (I. Ajeti „E. Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare në „Gjurmime albanologjike“, Prishtinë, 2009 f. 19)

Jeronim De Rada, jo vetëm si njëri ndër pionierët e Rilindjes e njëkohësisht si njëri nga më të shquarit e asaj Epoke, siç u tha më lart, me ndihmesat e tij për alfabetin, për origjinën e gjuhës shqipe, për strukturën e saj fonetike dhe gramatikore, e, siç do të shihet më poshtë me poemat, me publicistikën dhe me veprat e zhanreve të tjera, i kontribuoi si rrallë kush tjetër përparimit të gjithanshëm të gjuhës shqipe. Prandaj, çështja e gjuhës së përbashkët letrare nuk mund t'ishte jashtë preokupimeve të tij. Përkundrazi, ai u përpoq ta trajtojë me të njëjtin interesim sikur çështjet e theksuara më lart.

De Rada mendimin rreth gjuhës së përbashkët letrare e ka shprehur përveç se tjetërkund edhe në letërkëmbimin që kishte me gjuhëtarin e shquar arbëresh Dhimiter Kamarden. Për kërshërinë e lexuesit po theksoj se shkëmbimi i mendimeve midis dy personaliteteve më të shquara arbëreshe rreth të gjitha problemve me përmasa kombëtare shtrihet në më shumë se dy dekada. U takuan disa herë në vitet e fundit të gjysmës së parë të shekullit të tyre për të vazhduar pastaj me laps e letër deri sa ky i dyti shkoi në përjetësi. Nuk u pajtuan fare për disa çështje, ndër të cilat ishte edhe ajo edhe shqipes së përbashkët letrare. Po fillojmë me këtë të fundit e ndonjë tjetre do t'i kthehem më poshtë. De Rada e mbronte me këmëngulje mendimin se e folmja arbëreshe e Kalabrisë duhej t'ishte baza e gjuhës së përbashkët letrare shqipe, sepse shqipja n'atdheun e të parëve të tij e të të gjithë arbëreshëve ishte bastarduar krejtësisht si pasojë e pushtimit të vendit prej mëse katër shekujsh. Këtë pikëpamje gjuhëtari arbëresh e kundërshtonte me të njëjtin kuti që përdorte De Rada për ta mbrojtur mendimin e vet. Shpresa e këtij të fundit që mund të quhet edhe iluzion ishte se „...një ditë do të vinte një shkrimtar i madh, një gjeni, i cili do të themelonte gjuhën e përbashkët shqipe“. Në këtë pikë dy arbëreshët e shquar „pajtoheshin“. I vura thonjëzat fjalës së fundit, sepse ai dakordim, në thelb, ishte edhe mospajtim për arsye se, deri sa Kamarda e priste, për De Raden ai shkrimtari i madh, ai gjeniu kishte arritur - ishte vetë ai. Poeti i madh, duke e marrë shembull Homerin, i cili, sipas tij, ndonëse i lindur jashtë trojeve helene, ishte themeluesi i kulturës së tyre. “Kështu do të jetë edhe për Shqipërinë“ këmbëngulte De Rada. Pra, gjuha e veprave të tij, do të bartet në trojet etnike dhe do të bëhet gjuha e përbashkët e të gjithë shqiptarëve. Kamarda ia kontestonte, ndër të tjera, edhe vendlindjen e Homerit, duke e argumentuar se shtatë qytete helene grindeshin mes vete duke e arsyetuar se cila prej tyre ishte vendlindja e poetit gjenial.

Është e habitshme se si De Rada mund të imagjonte se në gjysmën e dytë të shekullit XIX shqipja e këndeje Adriatikut ishte bastarduar! E pa parashikueshme për një personalitet të tillë! Edhe më i habitshëm është fakti tjetër, se poetit nuk ia tërhiqte vëmendjen, se vet arbëreshët e Kalabrisë e lexonin me vështirësi të mëdha, për të mos thënë se nuk mund ta lexonin fare poezinë e tij, prandaj as nuk mund ta shijonin artin që shprehej në ato vargje, për shkak të gjuhës së vështirë që e përdorte. Prandaj, mund të thuhet pa ngurim se De Rada për çështjen e

gjuhës së përbashkët kombëtare propozonte zgjidhjen më anakronike të mundshme, më antishkencore, prandaj edhe më antihistorike. Megjithatë, nuk mungojnë raste kur dijetarë dhe atdhetarë të mëdhenj në rrugëtimin e tyre të vështirë mund të rrëshqasin në ato përmasa që nuk priten prej tyre. Prandaj mund të befasoresh deri në atë shkallë sa që „të mbetesh pa mend“. Por nga e çastit si paradigmë e të pallogaritures, ajo gjendje shndërrohet në të përhershme me një reflektim të kundërt sa herë t'u kthehesh veprave të tyre të jashtëzakonshme, para të cilave nuk mund të mos përkulesh. E, e tillë ishte edhe ajo e De Rades.



Tani, do t'i kthehem asaj shpresës së Kamardës, të cilën e quajta iluzion në kuptimin që vetëm gjuha e një shkrimtari të madh do ta zgjidhte çështjen e shqipes së përbashkët letrare. Rrugëtimi i saj nëpër dekadat e një shekulli e dëshmoi këtë. Megjithatë, ajo shpresë e gjuhëtarit të shquar shprehte parandjenjen ogurmire se „ditët e mira paskëtaj vijnë“. Dhe ato erdhën; I solli Naim Frashëri, apostulli tjetër i shqiptarizmes i cili në kuadrin e Kauzës Kombëtare me veprën e tij të gjithanshme e sidomos atë letrare e ngriti gjuhën shqipe në atë shkallë që s'kishte qenë asnjëherë më parë. „Bilbili i gjuhës sonë/s'do dëgjonet tjetër kurrë“ lemeriste poeti i Sheperit të Zagorisë, sapo mori mandaten se idhulli i tij e i gjithë shqiptarëve i kishte mbyllur sytë për gjithmonë. E pas një çerek shekulli, poeti i liqenit me vargje krejt të papërsëritshme ia këndoi himnin: „... Ti rapsod që pranë shqipes dit' e

nat' i lodhe ballët... sepse hir të perndishmë kish kuvendi yt, Naim, Ajo këng' e tepërlumtur që më s'pati shëmbëllim...“. Pse të vazhdojmë me punimet e gjuhëtarëve të nderuar të cilët vetëm sa e zbërthenin përmendoren e ngritur në vargjet e mësipërme! Çerek shekullin e Naimit, ndonëse e ndjeu, Kamarda fatkeqësisht nuk e priti - De Rada e përjetoi. Edhe dy tri fjalë për dyshen e sapo përmendur arbëreshe: Për takimet e para me gjuhëtarin e rrallë të kohës poeti i madh shkruante: Shqiptar i vërtetë në zemër e në mendime. Ndërkaq Kamarda për poezinë e De Rades: Nga ana tjetër përveç vlerave jo të zakonshme të poezisë prej nga frymëzohet, shkrimet e këtij lëvruesi të palodhur përmbajnë fjalë shqipe që mund të mblidhen me aftësi e dituri“. Edhe diçka nga ajo vister mospajtimesh „, Kështu që, sipas jush, duhet besuar se shqipja e vërtetë u gjendka vetëm në kolonitë arbëreshe...

Por ndoshta është i kotë debati midis nesh, sepse nuk besoj t'arrij t'ju bind... Por kjo nuk duhet të na pengojë që ne të jemi miq dhe, mundësisht, ta ndihmojmë njëri - tjetrin...“ i shkruante Kamarda poetit të madh. Për të vazhduar në letrën e fundit sipas J. Kastatit „Fort i dashuri De Radë, kam marrë letrën tuaj... unë e kam pritur me gjithë zemër themelimin e një shoqërie të tillë si preludin dhe si fillimin e një bashkimi real mes shqiptarëve... Të më keni si një nga miqtë e tu...“ Këto fragmente të shkurtëra i radhita këtu më sipër për të parë se dy arbëreshët e shquar pavarësisht nga mospajtimet e shumta për aspekte të ndryshme të çështjes kombëtare e vazhduan bashkëpunimin, e respektuan njëri - tjetrin dhe asnjëherë nuk ranë në ato pozita që më së paku muund të quhen të mjera.

Shkurt, mendimin e De Radës, për gjuhën e përbashkët letrare, përveç Kamardës, i cili për këtë çështje kishte edhe një mendim tjetër se „Duhet pyetur më përpara vet kombi në vet truallin e vet“, e kundërshtuan edhe arbëreshë të tjerë. Ndër ta Zef Skiroi shrehej tekstualisht: „Gjuha e De Radës nuk është dhe nuk do të jetë kurrë letrare e shqiptarëve“. Kundërshtimet mbështeteshin në argumente të cilat në vetvete përmbanin edhe rrugë të tjera për zgjidhjen e çështjes. Prandaj ajo betejë problemin e gjuhës së përbashkët letrare e çoi së paku një hap më përpara. Në këtë aspekt mund të thuhet pa ngurim se edhe De Rada e dhe kontributin e vet të pakontestushëm.

II

A) DE RADA POET

Maja e lisit deradian, gjethet e të cilit nuk do të vyshkën asnjëherë, është vepra e tij poetike. Mund të thuhet kështu për arsye se në të hapet faqja e re e letërsisë shqipe, hapet epoka e letërsisë gjithëkombëtare. Pra, me atë vepër është shënuar një kufi historik, një kthesë në kulturën shqiptare përgjithësisht. Prandaj, sa herë të shkruhet rreth çështjeve të kësaj natyre, vepra poetike e De Radës do të vlerësohet, siç është vlerësuar edhe deri tash, si themeli i epokës së re në letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Muza deradiane sajoi një vepër madhore në kuptimin e plotë dhe më të gjerë të kësaj fjale. Ajo shquhet me një gjerdan vlerash artistike, të cilat, siç do të shihet më poshtë, studiuesit kanë marrë guximin për t'i krahasuar me ato të letërsisë europiane të periudhave të ndryshme. Prandaj, mund të thuhet edhe kjo se pas 400 vjetësh, pra, pas Marin Barletit, De Rada është i dyti nga gjiri i kombit shqiptar që u bë pjesë e kulturës europiane. Duke iu qasur së afërmi kësaj veprë më duhet ta përsëris se për shkak të natyrës së punimit, jam i detyruar që veçoritë dhe vlerat e saj t'i trajtoj vetëm në vijat e përgjithshme. Dhe, për të mos i mbetur borxh lexuesit, për sa thash më lart, do të jap opinionin e disa shkrimtarëve dhe studiuesve europianë. Do të përqendrohem, pra, vetëm në tri poemat e tij kryesore, duke i kapërcyer edhe „moterzimet“ e tyre, ndonëse ndonjëra edhe me titull tjetër, konsiderohet si vepër e veçantë.

„Këngët e Milosaos“ Muza e jashtëzakonshme, po e përsëris, në njëren dhe formimi kombëtar që e mori në bankat e kolegjit, ku përveç të tjerëve, e pat për mësues edhe t' iatin, në anën tjetër rezultoi me poemën „Këngët e Milosaos“. Të tri motivet e saj – patriotik, shoqëror dhe erotik janë të gërshetuara në ato përmasa sa që mund të konsiderohen si lëgurë e poemës në këtë aspekt. Cili është boshti i saj? Pa dyshim ai patriotik, sepse pavarësisht nga „përqindja“ e tyre në 32 këngët e kësaj veprë, ndonëse edhe në këtë aspekt e ka „shumicën“ është zhvillimi i subjektit nëpër leqet dhe udhëkryqet e tij prova që dëshmon atë që u tha më sipër: Në këngën e tretë e bija e Kallogresë duke e konsideruar Milosaon si prijës e quan „flamur“. Siç dihet, heroi lëshon kushtrimin: „erdhi dita e Arbërit“ dhe në fund bie në altarin e atdheut. Një shembull të tretë që e provon çështjen që po e trajtojmë do ta paraqesim më poshtë; ndonëse në vepër ka shumë të tjerë. Tematika dhe koha e zhvillit të ngjarjeve: Përpjekjet e popullit shqiptar për ta çliruar vendin nga pushtuesit turq dhe vendeikas në

çerekun e parë të shek. XV; Më sakt në vitin e lindjes së Kryeheroit shqiptar, pra, me 1405 dhe përfundon me 1423. (J.K Vep e cit f. 235) Nuk mund ta shtjellojmë zhvillimin e subjektit, përveç ndonjë rasti të rrallë që ka përmasat e ndonjë kthese e që përcakton edhe të ardhmen e personazheve. As idilet e dashurisë midis dy të rinjëve , të cilat, nga aspekti artistik janë të rralla nuk kemi mundësi që t'i përshkruajmë. Kjo vlen edhe për personazhet e veprës. Njëri prej dy rasteve të pashmangshme në kuadrin e subjektit është „barrikada“ që dy të rinjët nuk kishin si ta kapërcenin për t'i realizuar ëndrrat e tyre për një jetë të përbashkët familjare. De Rada fiksionit si një nga veçoritë më të rëndësishme të artit letrar i jep trajtën e një fatkeqësie natyrore – Shkodra goditet nga një termet, pasojet e të cilit ishin të rënda. Përveç të tjerave shtresat shoqërore njëjtësohen, prandaj edhe Milosao, bir i sundimtarit të qytetit tashmë të rrënuar, ishte i barabartë me Rinën – bijë e një familjeje fshatare. Mbase, në këtë mënyrë poeti e shprehte edhe idealin e tij shoqëror. Këtu përfundojnë fiijet e këtij motivi.

I dyti: Milosao midis dy zjarresh - Detyra ndaj atdheut në njëren dhe dashuria e paskajshme për Rinën në anën tjetër. Për të dalë nga gersherët e kësaj dileme, e dilemes hamletiane, nëse mund ta quajmë kështu, në kuptimin më të gjerë të fjalës, e ndihmojnë nëna - Zonja e Madhe bashkë me të bijën e Kallogresë: „ Në qytet tash gjithë duan - të marrësh pjesë me t'arbreshët - kundër të huajit“. Milosao, i kthyer përkohësisht nga lufta, me ndërjegje të vrarë, me që s'e kishte kryer detyrën ndaj atdheut në ato përmasa që kishte dëshiruar nëna e tij: „ ... Kryelarta nënë e shkretë - pat besim t'isha në ballë - për çlirim të Shkodrës sonë - prej halldupit Venedik“. Prandaj, vendos që amanetin e nënës ta çojë në vend. Heroi bie në altarin e atdheut: „ Frye erë e maleve - rrëzoi hijeshinë e lisit – gjaku im të lumi i Vodit... Kushtrim ky që e lëshoi poeti për të gjithë shqipatrët kudo që gjendeshin për t'i rrokur armët për çlirimin e atdheut nga pushtuesi. Motra - Fjalët e fundit që hero i arriti t'i shqiptojë: „ Hapnje o ushtarë tendën - të shoh Shkodrën dhe time motër“. Me kaq më duhet ta përfundoi „rrëfimin“ edhe për personazhet.

De Rada, për të krijuar këtë vepër dhe të tjerat pas saj u mbështet dhe u frymëzua nga këngët popullore arbëreshe, për mbledhjen e të cilave dha ndihmesën e vet krahu paraardhësve të tij. Në këtë aspekt poeti është në të njëjtën linjë me shumicën e romantikëve europianë, të cilët visarin popullor e konsideronin si vlerë të veçantë të kulturës së

popujve që e kanë krijuar gjatë shekujve. Në radhë të parë është fryma kombëtare e atyre këngëve popullore që e përshkon tërë veprën poetike të De Radës: Epoka që i këndohet në ato këngë është ajo e Skënderbeut. E njejtat tematikë, e njejtat epokë. Edhe struktura kompozicionale me fragmentaritetin që e karakterizon poezinë e De Radës aty e ka burimin, bashkë me arsenalin e figurave poetike. Edhe natyra me pamjet e saj të larmishme, me pejsazhet e fushës, të detit përbën një segment tjetër të rëndësishëm të kësaj vepre. Edhe në këtë aspekt vepra e De Radës përkon me atë të romantikëve europianë. Me botimin e poemës „Këngët e Serafina Topisë“ De Rada „liçenohet“ si poet i madh. Përveçse me titullin - emrat e personazheve kryesore janë pjesë e tij - të dy veprat e kanë të përbashkët edhe tematikën me dy motivet të cilat e përbëjnë thelbin e përmbajtjes së tyre: Luftën heroike të shqiptarëve për lirinë e vendit dhe idilen e dashurisë në mes dy të rinjëve në të dy veprat.

Një tjetër veçori e përbashkët është mbështetja e poetit si në të parën në këngët popullore arbëreshe. Ndërkaq, e re në të dytën është se lexuesit i del përpara, qoftë edhe në shkallë epizodike figura e Skënderbeut. Një tjetër veçori që karakterizon poemën e dytë është se De Rada aty ka ngritur një nga çështjet më të rëndësishme për fatet e kombit në çdo kohë. Emri saj ishte bashkimi, ideal ky për të cilin duhej të përpiqeshin shqiptarët, pavarësisht çmimit që mund të kishte në rrethana të ndryshme. Në vepër kjo porosi përcillet me vendimin e vështirë që Serafina nga Arta vendosi ta marrë, duke e flijuar dashurinë e zjarrtë që e kishte për Bozdarin dhe duke u martuar me princin nga veriu Nikollë Dukagjinin; me qellimin e vetëm që t'i bashkojë dy skajet e atdheut në luftë kundër pushtuesit. Këtu mund ta tërheqim një paralele midis dy poemave në kuptimin e vështirësive për t'i realizuar synimet e veta. Derisa në „Këngët e Milosaos“, siç u tha, „barrikadën“ De Rada e mënjanoi përmes fiksionit që konkretizohet me tërmetin në të dytën e paguan çmimin të dy protagonistët. Grishja e poetit ishte misionare meqë edhe gjatë Rilindjes, si në kohën e Skënderbeut përçarja pat marrë përmasa shqetësuese. Prandaj, duke e bërë të vetin kushtrimin e De radës, Rilindasit e ngritën në apoteozë. Ajo, me Mitkon e Jubanin, me Vreton e Kristoforidhin, për të mos vazhduar me emra të tjerë arriti kulmin me „ marsejezën“ shqiptare, siç e pagëzoi studiuesi i njohur A. Uçi poezinë e Pashkë Vasës „ Mori Shqypni e mjera Shqypni“. Nuk mund të kapërcehet në këtë aspekt

trinomi frashëriot, bashkë me Mjedën për vargjet antologjike „ ... Prej Tivarit e n'prevezë - një a giuha e kombi një“ (Shih kumtesat e A. Uçit e Dh, S. Sh. Në Konferenca Kombëtare e Studimeve për LSHP, 1878 - 1881, Tiranë, 1979, f. 67-82; 173-183).

Po të kihet parasysh pesha e asaj epidemie për fatet e kombit e të atdheut, De Rada poet me këtë segment të veprës së dytë poetike merr përmasat e një ideologu të çështjes kombëtare. Në rrafshin artistik çastet dramatike që i përjetojnë Bozdari e Serafina janë të një vlere që vetëm mund të lakmohet. Vepra është një poemë epiko – lirike e dendur me përshkrime të larmishme të personazheve dhe veprimeve të tyre. Në krahsim me „Këngët e Milosaos“ numri i personazheve në këtë poemë përveçse më i madh është shumë më i larmishëm. Sa për protagonistin Bozdar Stresin studiuesit theksojnë se është figura më madhore e poezisë deradiane. Ndonjëri prej tyre e konsideron aq të skalitur artistikisht sa që është i denjë për pendën e Shekspirit. Numri i personazheve që parakalojnë nëpër faqet e poemës nuk është shumë i madh. Përveç Skënderbeut e Bozdarit mund të përmenden këtu edhe Nikollë Dukagjini, Davadesa, Goneta, Serafina, po se po, Astiri etj. Megjithëse në poemë nuk mungon ndonjë skenë që paraqet epizode të jetës intime të poetit, boshti tematik i saj është Çështja shqiptare në të gjitha aspektet.

Vepra jetësore e De Radës është „Skënderbeu i fat“, të cilën poeti e mbajti në tavolinë afër një gjysëm shekulli. Vargjet e saj të para janë të viteve kur u botua „ Këngët e Milosaos“, gjatë asaj periudhe poeti e përpunoi vazhdimisht. Projekti i tij ishte i habitshëm, synonte shkrimin e një epepeje jo vetëm për Skënderbeun por për atdheun e të parëve dhe kombit të cilit i përkiste. Nga aspekti strukturor dhe kompozicional ishte projektuar jo më pak se në 12 libra, nga të cilat arriti t'i botojë vetëm gjashtë prej tyre. „ Gjon Huniadi“ e cila u zbulua pas vdekjes së poetit dhe pesë vëllimet tjera, dorëshkrim gjenden sipas deradianit të mirënjohur J.Kastrati në Bibliotekën Qytetare të Kopenhagenit.

Kërkues i pamëshirshëm ndaj vetvetës, De Rada në vitet e pleqërisë së tij të thellë iu kthye prapë veprës, ndonëse ajo kishte një çerek shekulli jetë në duartë e lexuesve. „Nuk mund të më gjykoni me drejtësi, po nuk e lexuat edhe njëherë këtë poemë timen të reformuar. Aty pasqyrohet një faqe e jetës e ndryshme dhe e vetme pas asaj që na ka dhënë Homeri pagan“, shkruan De Rada para se të shkonte në

përjetësi. Këso note, siç do të shihet më poshtë, i dhanë poetit tanë disa nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë europiane të asaj kohe. Prandaj, mendojmë se rreshtat e mësipërm duhet t'i kuptojmë më tepër si një përceptim të poetit, i cili, së paku e ndjente që kombit dhe kulturës së tij po i linte trashëgim një monument letrar të përmasave homerike. Rrugëtimi i heroit në tri poemat e De Radës: deri sa në të parën asnjë rresht për të, pra, as emri i tij, në të dytën epizodik, kthimi i tij në Krujën legjendare, ndërkaq, në të tretën, që në titullin e saj. Lexuesi i kohës nuk mund të mos ishte i befasuar me faktin se Skënderbeun do ta takojë në ato përmasa që mund të quhet episodik. Atëherë, kush përjetësohet në „ Skënderbeu i pa fat“? Përjetësohet qëndresa mitike e popullit shqiptar në mbrojtje të atdheut; përjetësohet lavdia e atij shekulli që e mban emrin e tij në historinë tonë. Po ai shekull ishte edhe i pa fat se pas vdekjes së kryeheroit vendi ra nën kthetrat e pushtetit i cili, solli me vete atë zezonë që zgjati më tepër se katër shekuj. Po i kthehem befasisë së mundshme të lexuesit që e theksova më sipër: Është ajo e paqëndrueshme? Jo. Argumenti: Në shumicën e veprave letrare të gjinisë epike apo dramatike që për titull kanë një emër të përveçëm, real apo të imagjinuar, ai është strumbullari i saj tematik rreth të cilit zhvillohen ngjarjet. Epilogu i tij ngërthen porosinë e veprës, idenë e autorit për çështjen e shtruar, e çfarëdo karakteri qoftë ajo. Mendojme se De Rada bashkë me epokën e ka përjetësuar edhe kryeheroin, emrin e të cilit e ka vu si titull të poemës. Ky prosede nëse mund ta quajmë kështu, është për t'u konsideruar si një nga vlerat artistike të veprës.

A mund ta kapërcejmë këtu Naim Frashërin, respektivisht poemën e tij „Historia e Skënderbeut“? Jo. Poeti i ka „dalë borxhit“ kryeheroit me përmasat që i ka dhënë në veprën e vet. Pra, në këtë aspekt kemi një dallim thelbësor midis dy poetëve të shquar. Të dy poemat i karakterizon historicizmi. Këtë të fundit në ato përmasa sa që një studiues i letërsisë shqipe e ka quajtur poemën „...një histori e vjershëruar“. Dihet se në aspektin artistik historicizmi është një nga të metat më të dukshme të çdo veprë letrare. Për t'i shpëtuar kësaj ai ind duhet të mbështillet me skena të larmishme që i përkasin fiksonit deri në atë shkallë sa ai të duket si një fije e hollë. Megjithatë, lavdia e dy titanëve të Rilindjes Kombëtare nuk zbehet aspak nëse vihen në dukje mangësitë që vërehen në veprat e tyre.

Duke iu kthyer prapë poemës së De Radës me qëllim që ta mbylli edhe rëfimin për të, me sa më pak rreshta po përpiqem t'i theksoj disa nga veçoritë thelbësore të saj. Së pari, gjysma e parë e shek. XV është koha në të cilën zhvillohen ngjarjet e veprës; ndërsa vendet, e tërë Shqipëria, nga Veriu deri në Jug dhe përtej saj deri në Azi. Nuk mund ta përshkruajmë atë mal ngjarjesh, në të cilat pasqyrohet ajo mori personazhesh. Megjithatë, po theksoj se për të parën herë poeti ia paraqet lexuesit kryeheroin në këngët e para dhe pikërisht përmes fjalëve të babait të tij, i cili, lëngonte në shtratin e vdekjes: „ Ai do të vijë - e do t'i vrasë në shtëpi - që të na shpëtojë - me fat të bardhë për ne...“ Dhe në njërin nga këngët e radhës De Rada, tash, përmes fjalëve të të vëllait Reposhit e vë në rolin e shpetimtarit të kombit: „ Tashti, emri i shqipatrit - mbështetet te ti - e po kështu edhe shtëpia jonë“. Në anën tjetër, në vargjet e këngëve të tjera poeti e vë në dukje me epizode artistikisht të goditura se edhe heroi e dinte mirë detyrën dhe përgjegjësinë që ia kishte ngarkuar historia, prandaj vendosi për t'u dalë zot: „ Sot po ju lë, o besnik - të mi, me bujarët tuaj“...

De Rada e pasqyron edhe anën intime të Skënderbeut përmes të idileve të dashurisë me Frozinën kur ishte ende në shërbim të Sulltanit. Mendojmë se kjo është ndër cilësitë e veçanta të poemës. Numri i personazheve që i afrohet dyqindëshit, burra e gra nga vendet e ndryshme e në role pozitive e negative i japin veprës përmasa të gjera. Dhe, në fund, mbështetja në këngët popullore arbëreshe bashkë me fragmentarizmin janë veçoritë thelbësore që, siç është thënë edhe më sipër e karakterizojnë tërë veprën poetike të De Radës. Ideja e çlirimit të vendit që përçohet përmes përmbajtjes së saj, poeti synonte ngritjen e vetëdijës kombëtare të shqiptarët e shek. XIX; është kushtrimi që ai lëshoi për t'i rrokur armët kundër pushtuesit.

Vepra, në saje të përkthimit që i bënte vetë poeti në gjuhën e vendit ku jetonten u bë pjesë e letërsisë europiane, të cilën edhe e vlerësuan lart disa nga përfaqësuesit e saj më të njohur. Prandaj, nuk mund të mos citohen këtu disa prej tyre: Po e nisi me V. Hygoin: „Kush dëshiron të shoh plotësimin e poezisë romantike moderne, të lexojë këngët e Milosaos të zotëri Jeronim de Radës“ ky citat ka një histori të cilën po e shtjelloi sa më shkurt që është e mundur. Arbëreshi i njohur Vinçenc Dorsa punimin rreth „ Serafina Topisë“ e nis me tekstin e mësipërm por studiuesi italian Gualtieri, i cili edhe vet e çmoi lart poezinë e De Radës duke theksur ndër të tjera se „ Vdekja e Bosdarit është e denjë

për pendën e Shekspirit se „, Skënderbeu i pafat“ korrespondon me „Legjenda e shekujve“ të Hygoit, pohimin e Dorsës e konsideron të paqenë. Ndërkaq, peripetitë e asaj historie i mbylli studiuesi Jup Kastrati, i cili pohon se tekstin e romantikut të madh francez e kishte lexuar në revistën „Il Calbrese“ në vitin 1981 (shih referencën nr 20 në Vep. e cit më lartë f.262). Po, ende s'e kryem me Hygoit i cili me A. Dymanë e kanë quajtur De Radën Dante ose Homer i shqiptarëve. Vlerësimi i tyre, deri tash, nuk është vënë në pikëpyetje nga ndonjë studiues por kur dhe në ç'rrethana ai e lexoi poezinë e De Radës nuk është ndriçuar deri tash. Megjithatë, një kufi është dhënë: konsiderata është më e hershme se ajo e Lamartinit e shprehur me 1844 (Dh. S Sh. Vep. E cit f. 182), i cili i entuziasmuar por, pa dyshim, edhe i befasuar me vlerat artistike të arbreshit të shquar nuk u përmbajt pa shprehur admirimin e tij: „Zotëri, jam i lumtur për këtë shenjë vëllazërimi poetik e politik midis jush e meje. Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja dhe atje duhet të rikthehet. Unë s'kam tjetër meritë veç se të parandjej këtë dhe të bëjë urimet e para për lirinë e për ngjalljen e Shqipërisë. Ju, me këtë më shpërbleni për së tepërti“.

Jo më pak fascionuese është pikëpamja e F. Mistralit, të cilin e kanë quajtur Homerin e Provencës „... Iu uroj Zotni, që ju u keni kushtuar muzën tuaj, dashurinë tuaj dhe qenien tuaj kulteve të gjuhës suaj nënë, për lavdinë e vendit tuaj e të racës suaj ... Gjuhët natyrale nxjerrin në shesh fshehtësinë e poezisë së vërtetë. Të jeni, pra, të gëzuar që keni zgjedhur për të hartuar psallmet e Shqipërisë suaj të ëmbël. Poezitë tuaja të dlirta e të urta janë monumentet e atdheut tuaj. „Panoramën“ frenge po e përthekoj me vlerësimet e studiuesit C.C. Kamet, i cili i skruan De Radës „...Lutja e juaj drejtuar Virgjerreshës është një kantikë nga më të frymëzuarat dhe nga më prekset, që unë kam lexuar ndonjë herë... Ju thoni në librin IV se ju padisin për „mungesë“ arti për sa i takon hartimit të pjesëve të një së tërë së bashku. Por, edhe kjo e metë, për të cilën iu padisin jo vetëm që s'është mungesë arti po për mua është pika më e lartë e artit e cila qëndron në sekretin që t'i japësh krijimit ose fikSIONIT vulën më të dukshme të së vërtetës, gjithë duke e fshehur këtë sekret... E vetmja njësi e mundshme në këtë lloj hartimi është ajo që iu keni dhënë ju... Grupeve të ndryshme të Basorilieve tua... Dhe kush nuk e shikon që kjo qendër është atdheu i poetit, kjo Shqipëri krenare, Shqipëria e Skënderbeut! Është për të ardhur keq që Nikolla Tomazeu të mos ket thënë gjë për mbi këtë... Me një fjalë, unë

do të kisha treguar këtë shpirtë, këtë gjeni poetike të vërtetë që krijon gjuhën, në të njëjtën kohë me mendimin që ajo duhet të shpreh....,,

Gualtierit, të cekur më sipër, po ia shtoi këtu bashkatdhetarin e tij Nikolla Tomazeun i apostrofuar nga studiuesi francez, bashkëkohës e mik i poetit tonë, një nga figurat më të shquara të kulturës italiane të atij shekulli,, për të parë se edhe vlerësimi i tij për poezinë e De Radës është i të njëjtave përmasa: „...Dhe të vjetër dhe të re ka në fjalët tuaja, si të një atij që vënë re dhe ndjen të vërtetën... në psallm kemi kodrat, që gëzohen si qingjat. E, ndoshta, a nuk ngjason tjetër te Horci vallet e gracievet dhe të ninmfavet në dritën e hënës? Dhe them: më pak më pelqen në Danten... Të madhërishme janë vargjet „ Afërdita që ndritë nëpër pjergullën e rrushit aguridhës, i bën hije dritares... më i kthjelltë se në Dorotenë e lëvderuar prej Gëtes, është vasha që duke shkuar për ujë, kthehet në mes të rrugës... Dikush tjetër thotë se këngët tuaja janë tepër të copëtuara. Por ju që cekëni pëllumbeshen e pavdekshme të Anakreontit më bën të dijë se nuk mund të përçohen në fillin retorik lëvizjet e lira të fluturuesve... Urime me një përulje të dashur. (J.K. Vep e cit. f. 305-312).

A ka të tjerë nga „ekipi“ european? Po. Disa po i kapëcej se këta që u cekën mjaftojnë; pastaj ndonjëri nga të kapërcyerit mund të na zë rrugën edhe më poshtë. Prandaj fragmenteve të cituara më sipër po u kthehem vetëm me disa rreshta. Ato dëshmojnë katërçipërisht se vepra poetike e De Radës ishte bërë jo vetëm pjesë e letërsisë europiane, po edhe një kryevepër e saj. Me të tjera aty nderohet bashkë me poetin edhe letërsia e re shqipe, hullinë e parë të së cilës e hapi ai vetë. Edhe më tej „Aty nderohej atdheu i të parëve të tij - Shqipëria „ e pa qenë“ me popullin e saj heroik, „ajo mbeturinë e historisë“ „ ajo terranulius“ për vendimmarrësit gjakatarë europianë në dekadat e atij shekulli. (A. Buda: Konferenca Kombëtare e Studimeve për LSHP - 1878-1881 I, Tiranë, 1979 f. 11).

Po i kapëcej edhe vlerësimet e asaj plejade studiuesish arbëreshë, jo për shkak se s'paskan lënë gjë për t'u cituar. Përkundrazi, puna e tyre është e admirueshme, prandaj është pasqyruar gjerësisht në monografinë e deradianit Kastrati. Po i lë anash vetëm pse janë të „shtëpisë“. Megjithatë, do t'u hynim së tepërmi në hak sikur të mos ndaleshim shkurtimisht rreth veprës së më të shquarit në mesin e tyre. Mikel Markiano i botoi punimin me titull „ Shqipëria dhe vepra e Jeronim De Radës“ vetëm pak muaj para se poeti të shkonte në

përjetësi. Monografia me rreth katërqind faqe jo vetëm që përbën kulmin e studimeve arbëreshe, por ajo mbeti vepra themelore për disa dekada të shekullit XX për të gjithë ata që i çaseshin kësaj figure mahnitëse të kulturës shqiptare. Si më sipër, po i citoj vetëm disa nga vlerësimet e atij studiuesi. Për bashkëvendasin e De Radës ndjenja njerëzore e popullit shqiptar është skalitur sikur në „diamant“. Deri sa „...Kanconieri i poetit italian (Petrarkës) është një zingjir i artë përpëlitjesh, kanconieri i poetit arbëresh (Këngët e Milosaos) është nisja e një zingjiri të artë portretesh... Skenën e takimit të parë të Milosaos me Rinën e kërkon kot në idilet e Teokritit dhe të Gesnerit“ (J. K. Vep. e cit. f. 328-31). Siç po shihet, edhe nga ky studiues i shquar vepra e poetit arbëresh vlerësohet lart duke e krahasuar madje pa ngurim me poetët e shquar europianë që u përkasin periudhave të ndryshme historiko - letrare.

Po Rilindasit e këndeje Adriatikut ku janë? Emrat aty, madje në rreshtat e parë të atij regjistri. Në ballë trinomi frashëriot e pas tyre Jubani e Kristoforidi, Mitko e Spiro Dine, Vretoja me Asdrenin e Gurakuqin, për të mos i përmendur të gjithë. Rënditje e mbarë bashkë me përzgjedhjen. Tani, befasia paradoksale: studiuesi J. Kastrati s'ia ofron lexuesit asnjë rresht të asnjërit nga emrat e sapo përmendur! Kjo mangësi, që s'mund të arsyetohet nga askush dëshmon se nga njëherë edhe ata, valixhja shkencore e të cilëve është plot vlera të lakmushme, çalojne edhe aty ku nuk pritet fare.

Nëse popujt e mëdhenj krenohen me personalitet që kanë nxjerrë nga gjiri i tyre si gjermanët me Gëten e Shilerin, italianët me Dantën e Petrarkën. Francezët me Balzakun e Hygoin, rusët me Pushkinin e Tolstoin Shqiptarët duhet të ndjehen edhe më krenarë për De Radën e tyre të vlerësuar derin në pikën më të lartë. Duhet të jemi krenarë që ky vigan i kulturës sonë arriti që letërsinë tonë ta fus në rend me letërsinë më të zhvilluara të këtij qytetrimi. Do të duhej të jemi krenarë se vepra e De Radës u bë arenë diskutimesh e vlerësimesh pro dhe kontra nga mendjet më të çmuara të kulturës europiane të asaj kohe e që ne, në pika të shkurtëra, ia ofruam lexuesit si një panoramë në fund të kapitullit De Rada poet.

B) DE RADA ESTET

Si fryt i dhuntisë së jashtëzakonshme krijuese, dhe i njohjes, gjithashtu, të jashtëzakonshme të literaturës antike greko-romake, të Rilindjes Europiane dhe shkollave pasardhëse rezultuan „Parimet e

estetikës“ që u botua në vitin 1861. Për mendimin e shprehur në mënyrë të prerë po e citoj që në fillim me kënaqësi studiuesin e mirënjohur të letërsisë shqipe R. Qosen rreth komponentes së dytë që u theksua më sipër: „ Parimet e estetikës, ndërkaq, e tregojnë De Radën si një shkrimtar me kulturë filozofike dhe estetike të gjerë, madje, mund të thuhet me kulturën më të gjerë deri në ditët tona në letërsinë shqipe“. Për të vazhduar më tej „ në perspektivën e zhvillimit historik letrar, vepra „Parimet e estetikës“ bëhet një dëshmi se letërsia shqipe po hynte në rrjedhat e letërsisë dhe, në përgjithësi të mendimit europian“ (R. Q. Vep e cit f. 141 - 163). Për të mos iu kthyer më po theksoj se ky studiues, krahas vlerësimit kapital që sapo u citua, i vë në dukje edhe disa mangësi të kësaj vepre, bashkë me arsyet se përse ato janë reflektuar. Nuk është vendi të ndalem rreth tyre, por mund të thuhet se disa nga mendimet e tij janë vërtetë të mbështetura, e disa të tjera, për ndonjë dijetar të mirëfilltë të kësaj fushe mund të jenë edhe të diskutueshme.

Me traktatin Parimet e Estetikës De Rada shpalos flamurin e Prijësit edhe në këtë fushë të vështirë të studimeve shqiptare. Dhe u dasht të kapërcejë një shekull i tërë që pranë gurit të tij të vihet i dyti me veprën „ Estetika Jeta Vepra Arti“ e dijetarit të shquar Alfred Uçi, i cili me disa vepra të tjera të këtij zhanri gjatë këtyre katër dekadave, jo vetëm që e përthekoi themelin e nisur nga poeti i madh arbëresh, po i ngriti edhe katet e para të kësaj godine shkencore në literaturën shqiptare, të cilat vetëm sa mund të lakmohen.

Para se t'u kthehem vlerësimeve të Markjanoit, i cili, së paku për 70 vjet është konsideruar si studiuesi më i shquar i veprimtarisë së gjithanshme të De Radës, po e pasqyroj shkurtimisht objektin dhe strukturën „kompozicionale“ të Parimeve. Duke ecur gjurmëve të dijetarëve europianë, veprat e të cilëve, siç u tha më sipër, i njihte në shkallë të lakmueshme, kategoritë estetike De Rada i trajton në përmasa të ndryshme. E bukura, si njëra prej tyre, e ka tërhequr më së tepërmi vëmendjen e poetit, duke e analizuar gati në të gjitha aspektet. E Madherishmja bashkë me Komiken janë trajtuar gjithashtu në përmasa mjaft të gjëra. Ndërkaq, e Shëmtuara është kategoria estetike që më së paku ka tërhequr vëmendjen në këtë rast të studiuesit arbëresh. Një ndër arsyet për këtë do të theksohen më poshtë. Për t'i shprehur pikëpikëjet e veta rreth çështjeve që u përkasin kësaj fushe, De Rada zgjodhi si metodë bashkëbisedimin me shkrimtarë e

filozofë të shquar. Dialogu, pra, përbën strukturën kompozicionale të atij traktati. Edhe në këtë aspekt është në hullinë e hapur nga pararendësit e shquar europianë, natyrisht të disave prej tyre. Lexuesin nëpër radhët e atyre dialogjeve vëren pa vështirësi se De Rada me disa prej tyre pajtohet pjesërisht, me disa tërësisht e me disa të tjerë që nuk janë të paktë i kundërshton për shumë çështje që përbëjnë objektin e kësaj fushe. Pra veprën e karakterizon një tis polemizues.

Po i kthehem tash qëndrimin „mospërfillës“ të De Radës ndaj të shëmtuarës. Në këtë aspekt poeti ynë i madh është në akord me parëndës europianë, të cilët, ndonëse ky segment i realitetit njerëzor ishte pasqyruar në veprat më të shquara letrare që nga periudha antike nuk e njihnin atë si kategori estetike, duke këmbëngulur se e shëmtuara s'mund të jetë njëkohësisht edhe e bukur. Këtu duhet shtuar se vëzhgimet, modeste dhe serioze, që i përkasin kësaj fushe shtrihen nëpër shekuj të tërë. Po theksojmë këtu se „termi Estetikë“ në kuptimin e plotë të kësaj fjale u përdor në mesin e shekullit XVIII nga dijetari gjerman Baumgarten. Aty, pra, fillon konsolidimi i kësaj disipline në rrafshin teorik. U dasht të kalojë edhe një shekull derisa studiuesit e braktisën pikëpamjen e theksuar më sipër (shih këto gjerësisht: A. Uçi „Estetika e Groteskut - Teoria dhe Historia libri I, Tiranë 2001, f. 8,9,10 e në vazhdim). Prandaj, De Rada, në atë kapërcyell pikëpamjesh thelbësore, nuk arriti t'u bashkangjitet dijetarëve që e hapen shtegun e ri në fushën e estetikës. Është mjaft sinjifikative e dhëna se poeti nuk iu kthye më asnjëherë kësaj veprë siç veproi me të tjerat.

Tani, t'i shohim disa nga vlerësimet e bashkëvendësit të De Radës „... Po si Tassoja dhe Shileri, që i mblodhën parimet e poezisë së tyre në një teorikë të posaçme të së bukurës, i pari duke i nxjerrë nga veprat e veta dhe i dyti nga estetika e Kantit, kështu edhe De Rada i grumbulloi në një traktat parimet eprore, mbi të cilat mbështeten poemat e tij... Vepra që mua më duket me një rëndësi jo të rendomtë... Teori e cila nuk është ajo rreze e pakapshme e esencës hyjnore që i shfaqet, sipas Platonit botës së padukshme, as ajo sferë sublime e përjetshme dhe nebulore e Lajbnicit, të cilën pasonjësit e këtij e zgjatën në infinit... Kjo në vija të përgjithshme, është teoria e tij mbi të bukurën... që e ka bazën mbi të mirën. Si Shileri edhe De Rada pasi thuri poema, deshi të ndërtoi një sistem estetik që, në mos është një zbulim ka origjinalitet (J.K. Vep e cit. f. 333-33).

Këta rreshta përbëjnë vetëm një pjesë të vogël që autori i monografisë i ka cituar për t'ia paraqitur lexuesit pikëpamjet e tij për parimet e estetikës. Po, Krahas këtyre vlerësimeve të favorshme, Markiano i ka bërë edhe një varg vërejtjesh rreth të cilave këtu nuk e shoh të arsyeshme të zgjatem.


C) DE RADA FOLKLORIST

Arbëreshët, kur u vendosën në viset e Italisë jugore nuk ishin duarthatë. Ata morën me vete nga atdheu i tyre lavdinë e Motit të Madh bashkë me fatkeqësinë e paharrueshme që pësoi atdheu kur ra në kthetrat e pushtuesit. Këtij binomi nëpër shekuj i shtohet vazhdimisht edhe malli për vendin e të parëve. Ky trinom përcillej nga brezi në brez sidomos përmes këngës. Dhe, erdhën dekadat për t'u kujdesur për atë pasuri të paçmueshme. Gjurmët e para të mbledhjes së këngëve popullore nga arbëreshët janë të shekujve XVII - XVIII. Ndërkaq shkenca shqiptare i njeh për të parë në këtë fushë gjyshin dhe babain e autorit të poemës „Kënga e sparsme e Balës“. Veprën e tyre e vazhduan edhe shumë arbëreshë të tjerë, në mesin e të cilëve ishte edhe De Rada që në vitet e rinisë së tij. Edhe hullinë e botimit të visarit popullor e filluan arbëreshë të tjerë para poetit të madh. Po, „Rapsoditë e një poeme shqiptare“ që u botua në Firencë më 1866, shkenca shqiptare e konsideron si të parën vepër të kësaj fushe në kulturën kombëtare. Vetë De Rada ia bën me dije lexuesit se ato këngë i mblodhën 11 veprimtarë arbëreshë, „...të cilët atdheut i kanë bërë një shërbim të madh që punuan për të mbledhur e bashkuar pjesët e ruajtura e të shpërndara të këtij monumenti të lartë“. Duke u mbështetur në tematikën e këngëve, respektivisht në subjektin e tyre, De Rada veprën e ndau në tri pjesë: Në të parën përshkruhet Shqipëria e lirë, në të dytën qëndresa heroike e shqiptarëve në luftën kundër pushtuesit turk dhe e treta ai rrëbesh i pashëmullt fatkeqësish me përmasa tragjike që e mbuloi atdheun e të parëve të tyre pas disfatës „ ... nga numri e jo nga trimëria“, bashkë me vajet po edhe shpresat për ta fituar lirinë dhe për t'u kthyer n'atdhe.

Vetë titulli i veprës dëshmon për bindjen e De Radës se të 72 këngët e saj janë pjesë e një poeme, e cila u bë thërrime nëpër shekuj. Për të qenë sa më bindës në këtë aspekt, ai bëri disa ndërhyrje në tekstet e tyre. Studiuesit e veprës përgjithësisht e konsiderojnë të pambështetur mendimin e më sipërm të poetit. (Ndër të tjerë edhe Jup Kastrati në Vep. E cit. f.183).

Me 1883 De Rada e ribotoi veprën me titull të ri: „Rapsodi Komëtare“ që dëshmon se autori nuk e mbronte më pikëpamjen e shprehur para dy dekadash. Botimi i parë që pritur me admirim nga rilindasit, ndër të cilët po i përmendim përveç Kamardës edhe Vreton e Kristoforidhin bashkë me V. Frashëri, dhe me folkloristët e më vonshëm si Mitkoja me Spiro Dinën. Ndërkaq, Elena Gjika e frymëzuar nga vepra e shkroi studimin e njohur botërisht „Kombësija shqitare sipas këngëve popullore“, ku ndër të tjera thuhet: „Rapsodi...e quan si një epike kombëtare origjinale, si histori të atdhetarëve shqiptarë që ranë për liri, pavarësi dhe qytetërim“.

Në saje të përkthimit në gjuhën italishte „ Rapsoditë ...“, tërhoqën vëmendjen edhe të qarqeve kulturore e shkencore europiane. Mund të thuhet pa as një ngurim se vepra e përforcoi edhe më tej bindjen e opinioinit përparimtarë european për ciliësitë që e karakterizojnë popullin shqiptar si trimëria, mikpritja, besa etj., në një kohë kur qarqet anti shqiptare thurnin intriga e gënjeshtër nga më të paskurpulltat se shqiptarët janë popull primitiv, pa literaturë, prandaj edhe pa kulturë dhe si të tillë nuk dinë të bëjnë jetë kombëtare, duke përfshirë këtu edhe formimin dhe organizimin e shtetit. Ndonjëri nga studiuesit e njohur nuk nguroi ta krahasojë De Radën me Xhejms Makfersonin, i cili, këngët që i kishte shkruar vetë, siç u zbulua më vonë pas një debati të gjatë në qarqet shkencore europiane, ia blatoi Osianit – një luftetari legjendar i shek. të tretë të epokës sonë. Vepra e poetit skocez pat një jehonë të jashtëzakonshme edhe në letërsinë e popujve me tradita të mëdha kulturore e të mos flasim për ndikimin e saj në letërsinë dhe kulturën e popujve që ende rënkonin nën kthetrat e pushtuesve të ndryshëm.



„Rapsoditë“ ishte kryevepra e folkloristikës shqiptare, kur u botua, dhe si e tillë mbeti edhe për dekada të tëra. Mund të thuhet se De Rada i arriti synimet e tij prej rilindësi si në rrafshin kombëtar, duke ndikuar edhe më tej në ngritjen e vetëdijës nacionale, ashtu edhe në atë kulturor. Tani, edhe në qarqet europiane, përveçse si poet , gjuhëtar, publicist e estet njihet edhe si folklorist që i kishte kapërcyer caqet e kulturës kombëtare.

Ç) DE RADA ILUMUNIST

Arbëreshët ishin të vetëdëshëm për rëndësinë e madhe që kishte shkolla shqipe për ruajtjen e gjuhës amtare dhe për ngritjen e vetëdijës kombëtare. Prandaj, përpjekjet e tyre në këtë aspekt i filluan në shekullin XVIII, përpjekje rreth të cilave këtu nuk mund të zgjatemi, por po theksojmë se me hapjen e Katedrës së Gjuhës Shqipe pranë Institutit të Shën Adrianit ato rezultuan me fitore përmasash historike

për kohën. Udhëheqja e saj iu besua De Radës, i cili, „ u bë mësuesi i parë i shkollës shqipe me karakter kombëtar“. Rinia arbëreshe për herë të parë filloi të arsimohej në gjuhën amtare. Në bankat e saj ajo mësoi për të kaluarën e stërgjyshërve nëpër shekuj.

Por Instituti ishte bërë dekada më parë një vatër revolucionarësh, „ një qerdhe volterianësh“, prandaj ishte vazhdimisht në shënjestër të regjimit reaksionar burbon. Nga masat represive që i ndërmori, e para pësoi katedra, e cila, pas tri vitesh veprimatrie atdhetare u mbyll. Pezmin ndaj padrejtësisë arbëreshët e shndërruan në përpjekje edhe më të organizuara për ta fituar të drejtën e tyre – shkollimin në gjuhën amtare. Më në fund ato përpjekje i dhanë frytet, kështu më 1868 hapet gjimnazi me drejtues prapë Jeonim De Radën, i cili kërkues ndaj vetvetes për të arritur sa më shumë në të gjitha segmentet e çështjes kombëtare, synonte rihpjen e Katedrës. Me 1891 e realizoi aspiratën e vet. Krajatat nuk kishin të ndalur, epilogu i të cilave u përserit si refren: De Rada largohet prapë nga auditoriumi, dyerve të të cilit iu vu dryni. Po, titani arbëresh në misionin e tij të shenjtë prej apostulli për gjuhën, shkollën shqipe dhe për çlirimin e atdheut nuk e njihte dorëzimin. Nuk e njihte dhe nuk kishte si ta njihte, sepse, përveç të tjerave, vitet e lavdishme të LSHP dëshmuuan se „... Pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjakë në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri e pavarësi...“ ; se „ ...Liria nuk vinte dot vetëm nga gryka e pushkës, pa kaluar edhe nëpër majën e pendës“. Për të parën e kishte dhënë kushtrimin përmes veprës së tij poetike, ndërsa për të dytën punoi me dekada të tëra, duke u bërë një nga protagonistët më të lavdishëm para e pas kushtrimit naimian me vargun emblematic „ dhe drit' e diturisë, përpara do na shpjer“ (citimet nga kumtesa e A. Uçit në „Konferenca Kombëtare e Studimeve për LSHP“ f. 67 - 72).

Prandaj në saje të këmbënguljes së De Radës në vitin shkollor 1902 - 3, pranë Kolegjit të Shën Mitër Koronës ngritet sërish Katedra e gjuhës shqipe e mësues kush tjetër veç deniurgut të kauzës kombëtare në muzg të jetës së tij në të gjitha aspektet, i papërkulur nga ai spektër dallgësh që u përplasën më tepër se gjashtëdhjetë vjet. Nuk mund të mos theksohet këtu se përveç Gurakuqit që përmendem më sipër në një mënyrë a në një tjetër „ nxënës“ të këtij apostulli, të këtij prometheu ishin edhe A. Xhuvani, A. Rrustemi, K. Cipo e Z. Kodra e

shumë të tjerë të cilët më vonë, secili në mënyrën e vet, e sollën mësuesin e tyre në Shqipëri (Dh. S. Sh vep e cit. f. 194-5).

Me disa punime, rreth të cilave nuk mund të ndalemi, De Rada e shkroi edhe „historinë“ e atyre vatrave arsimore; ndërkaq në përmasat e një teksti shkollor e botoi edhe „Antologjinë shqipe“. Në Kapitujt e parë është prezantuar visari popullor për të vazhduar me fragmente veprash të autorëve arbëreshë bashkë me të tija. Nuk mungojnë as pjesë veprash poetike të shkrimtarëve europianë. Lexuesi gjente aty edhe një varg letrash dërguar poetit arbëresh nga rilindësit e këndej adriatikut. Për kërshërinë e lexuesit po japim atë që Naimi e Samiu me Vreton ia dërguan De Radës për t'i shprehur ngushllimet me rastin e vdekjes së djalit të tij Zefit, me titull „Vaj mbi shtëpinë e radhëniet“. Dhembja e tyre shprehet edhe përmes vjershës së Naimit që gjendet brenda saj „Vllaster i lashtë i Shqipërisë - në dhethit të Italisë - Shqipëria kujt mirë i doje - Në gjuhët tënde e shqip shkroje - gjithmonë të kujton - ...Vretoja dhe Naimi - me Saminë të vëllanë - Mbrenda ndër zemërë ju kanë“ (J.K.Vep e cit. f.213).

Dihet se LSHP me veprimtarinë e saj të gjithanshme e hapi atë faqe të re e të lavdishme të Rilindjes Kombëtare duke i mobilizuar të gjithë shqiptarët kudo që gjendeshin për çlirimin e vendit. Njëra nga vatrave më të zjarra ishte dhe ajo e arbëreshëve në Itali me De Radën në krye, icili përveç të tjerave përpigëj dhe ia arriti që ta njoftojë opinionin europian për ngjarjet që zhvilloheshin në Shqipëri. Njëra prej tyre ishte edhe beteja që forcat ushtarake të Lidhjes e zhvilluan në Gjakovë kundër marëshalit turk M. A. P. Maxharit, i cili në emër të sulltanit kishte ardhur në Shqipëri për t'ia dorëzuar trojet tona Malit të Zi në bazë të Vendimeve të Kongresit të Berlinit. Ngjarjen e përshkroi në të përkohshmen „Fjamuri i Arbërit“, ndërkaq në „Antologji“ e riprodhoi në cilësinë e një tregimi popullor me vertetësi historike dhe për autor kishte gjakovarin Ton Gulia, i cili ishte anëtar i delegacionit të qytetit në bisedimet e zhvillara me të dërguarin e sulltanit (shih edhe K. Frashëri LSHP 1878 - 1881, Tiranë, 1997, f 148 - 51). E veçanta e këtij tregimi është rruga e mëtejshme e këtij deshmitari: Duke e lënë gruan me katër fëmijët në vendlindje arrin në Itali dhe nga Roma në shtëpinë e De Radës e sjell i biri Rodrigoja ku qëndroi 14 muaj si mik i tij (J. K. Vep e cit f. 209).

Në këtë rast nuk munt të mos i kthehem me pak rreshta kumtesës së Zija Shkodrës me titull „Mbi rolin e qyteteve në ngjarjet e Lidhjes së

Prizrenit“ ku rrëfen për aktin e Ramadan Zaskocit, i cili, me urdhër të Lidhjes e vrau telegrafistin e marëshalit turk në Prizren e nuk e thoët asnjë fjalë për atë që ndodhi në Gjakovë (Konferenca Kombëtare e Studimeve... Tiranë 1979 f. 290). E sa për sqarim duhet thënë se edhe qytetarët e Gjakovës e dëshmuar në vepër atdhetarizmin e tyre: „Thuhet se atë natë, M. A. Pasha i premtoi gjashtëmijë grosh atij që do t'i sillte një kotrovë me ujë, por asnjë nuk ia pruri nga urrejtja ...“ (tekst i cituar nga J. Kastrati f. 210). Më në fund, poeti e kishte dënuar n'atë informacion „zakonin“ se edhe armikun duhet mbrojtur nga kushdo që e kërcenon, nëse të ka ardhur në shtëpi si mik. Po, deri sa marëshali turk ishte armiku i Shqipërisë ai nuk duhej të gjente strehë në asnjë vatrë shiptare, e aq më pak në shtëpinë e një anëtari të Lidhjes.

„Antologjinë shqipe“, si e para vepër e këtij lloji në kulturën shqiptare, studiuesit e kanë vlerësuar lart nga të gjitha këndet, duke vënë në dukje edhe rëndësinë që ajo e pat në aspektin politik, meqë De Rada aty kërkonte asgjë më pak se pavarësinë e atdheut: „Ne duam atë të vetëm gjë që don çdo komb: një shtet më vete e për vete, ku të mblidhen të gjithë njerëzit e një gjaku, si familjet në shtëpiat e tyre“ (tekst i cit nga J. Kastrati). Ishte viti 1896.

D) DE RADA PUBLICIST

U përcaktova që këtë veprimtari të De Radës ta trajtoj në fund të këtij punimi, jo se është më e rëndësishmja, sepse dihet që nuk është , po për faktin se poeti edhe në këtë fushë i doli zot çështjes kombëtare ashtu qysh i ka hije një atdhetari të njëmendet. Po kaq, në mos edhe më i rëndësishëm është fakti tjetër se mendimin e tij politik që fqinjët e shqiptarëve, në radhë të parë, siç ishin në kohën e tij, do të jenë edhe më vonë dhe prore do të përpiqen për t'i gllabëruar trojet e tyre, për fatin e keq e vërtetoi katërçipërisht i tërë shekulli pas deradian, madje edhe me ndonjë dekadë përtej tij. Për këto që u thanë në rreshtat e fundit do të shtjellohen natyrisht pa i banalizuar.

Ngjarjet që u zhvilluan në Itali dhe vendet tjera me 1848 i dhanë atij viti përmasa europiane. De Rada tani poet, gjuhëtar e historian, nuk mund të ishte spektator, prandaj vendosi që qendrimet e tij politike t'i shpreh edhe përmes shtypit. Prandaj në shkurtin e atj viti pa dritën e botimit numri i parë i gazetës „L' Albanese d' Italia“ (Shqipatri i Italisë). Ai ishte guri i parë në themelin e kësaj fushe të kulturës shqiptare. Në formën e një paranteze do të ndalem rreth një të dhëne

që nuk mund të mos quhet paradoksale. Në konferencën shkencore kushtuar 100 vjetorit të LSHP, mbajtur në Prishtinë me 1981, R. Qosja e lexoi kumtesën, përndryshe mjaft të gjatë, me titull „Romantizmi dhe Lidhja shqiptare e Prizrenit“. Pasi vë në dukje se gazetaria ishte njëra nga mjetet më të rëndësishme, përmes të cilave Lidhja e kryente misionin e vet politik e kombëtar thekson: „Megjithëse edhe në etapën e parë të Rilindjes ishin bërë përpjekje për nxjerrjen e ndonjë gazete që trajtonte çështjet shqiptare në gjuhë të huaj, ose që i trajtonte edhe në gjuhën shqipe 12...“Kumtuesi nuk përmend emrin e asnjë gazete, respektivisht të asnjë botuesi.

Ndërkaq, në referencën e sipërhënuar tekstualisht thuhet: „ Profesor Aleks Buda në studimin „Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859 - 1861, e quan gazetë të parë shqiptare gazetën e Anastas Bykut nga Lekli i Gjirokastrës, Pellazgos, që filloi të botohet me 1 janar 1860. Më vonë gazeta mori emrin e kombinuar „ Pellazgotis“ dhe mban nën titullin shqip „ Shqiptari dhe Greku“. Gazeta dilte në gjuhën greke por nuk mungonin as materialet shqip. Mund të thuhet se ajo u kushtojë krejtësisht çështjes shqiptare“. Në Studime Historike 1965, nr. 2 f. 65.

E pabesueshme duket! Edhe komenti mund të duket i tepërt, sepse vetë lexuesi mund t'i bije në fije pa vështirësi këtij shkepimi. Edhe heshtja e kumtuesit bashkë me mënyrën e të publikuarit është pak e çuditshme, prandaj e meriton ndonjë rresht. Një nga të mundshmet arsye, ndoshta, është edhe kjo se duke e konsideruar krejt të paqënrueshëm, mospajtimin e ka shprehur ashtu qysh u tha më sipër. Përimtimi, mund të shkojë edhe pak më tej por këtu s'është vendi. Megjithatë, çështjen e sqaroi vetë historiani Buda, i cili në zërin për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar që i kushtohet atij veprimtari, nuk e përsërit mendimin e cituar më sipër (f. 37). Ndërkaq në zërin kushtuar gazetës „Pellazgos“, tekstualisht thuhet se ajo ishte „ një ndër organet e para të shtypit shqiptar“ (f. 817). E sa për „ Shqiptari i Italisë“ në këtë vepër përsëritet konstatimi se ajo „ është e para e përditshme në historinë e gazetarisë shqiptare (f. 589).

De Rada i trajtoi zhvillimet politike në Itali e sidomos në Napoli me ashpërsi të rrallë. Në shënjestrën e tij ishte regjimi i Burbonëve, i cili, i kushtoi shtrenjë. Ai e ngriti njëkohësisht edhe çështjen shqiptare në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare: „ Unë, thot poeti, mendova të themeloh një gazetë që të ndante në vjet e atdheut nga ata që kërkonin

prej tij një shpërblim“ (J. K. Vep e cit f. 266), ndarje taborresh kjo që fatkeqësisht e përshkoi vazhdimisht kauzën tonë e sidomos udhëkryqet e saj. Përveç artikujve të karakterit politik, De Rada botonte aty edhe fragmente nga veprat e tij poetike, poezi popullore bashkë me krijime të autorëve të tjerë arbëreshë. „Shqiptari i Italisë“ u prit me gëzim dhe u vlerësua lart nga lexuesit arbëreshë, vlerësim që u shpreh nga disa emra të njohur: E. Gjika e quajti „paralajmëtare e Lëvizjes Kombëtare Shqipëtare“, Ndërkaq Santori i shkruante De Radës „Më lejo të shpreh admirimin tim për këtë gazetë, ku me lotë ndër sy shoh emrin e saj me titull që i përgjigjet qëllimit tonë të përbashkët.

Burbonët ia paguan De Radës, siç u tha edhe më lart, mjaft shtrenjët qëndrimin e shprehur: e censuruan, e konfiskuan, e burgosën po dënimit i shpëtoi falë miqësisë së sinqertë nga ana e oficerit të policisë nga Himara, Dhimitër Leka, të cilit, poeti ia pat kushtuar poemën e parë „Këngët e Milosaos“. Përveç vështirësive politike, me të cilat u ballafaqua De Rada ishin edhe vështirësitë financiare ato që e detyruan publicistin që ta ndërpresë botimin e gazetës në gjysmën e atij viti.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX Lëvizja Kombëtare Shqiptare filloi të konsolidohet me ritme më të shpejta në të gjitha aspektet e saj. Në të njëjtën kohë marrëdhëniet ndërkombëtare ashpërsoheshin gjithnjë e më tepër. Tatëpjeta e Perandorisë Osmane dhe synimet ekspansioniste të Rusisë cariste përbënin boshtin e Krizës Lindore. Europa Perëndimore përpiquej ta „menagjojë“ atë. Lufta ruso - turke e vitit 1877 që përfundoi me marrëveshjen e Shën Stefanit në marsin e 1878 - tës, krizën e çoi në krizë për zgjidhjen e së cilës u organizua Kongresi i Berlinit. Vendimet e atij aeropagu trojet shqiptare i kishte fshirë nga harta e Europës - disa pjesë iu dhanë fqinjëve të tjerat mbeteshin pjesë e Perandorisë Turke. Për t'i bërë ballë këtij rreziku të jashtëzakonshëm për fatet e kombit shqiptarët, siç dihet, formuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, e cila mori gjithashtu vendime historike.

Në ato rrethana emri i të cilave ishte „të jeshë a të mos jeshë“ ose „liri a vdekje“, De Rada pasi i kishte mbështetur tërësisht vendimet e Lidhjes, me 1883 pra gati shtatëdhjetëvjeçar e nxori të përjavshmen „Fjamuri i Arbërit“, në të cilën i sulmoi pa mëshirë të gjithë armiqtë e mundshëm të kombit shqiptar, pa e kursyer as shtetin ku jetonte. Me

atë qëndrim prej atdhetari të vërtetë ai e ngriti vetëdijën e shqiptarëve kudo që gjendeshin përveç arbëreshëve të Italisë e të Greqisë edhe në viset e ndryshme të Europës e deri në Turqi. Për të parë këto dy segmente po citoj disa fragmente: „I dashur profesor, për ndërmarrjen tuaj fisnike me të cilën ne, të rinjët arbëreshë presim në çdo çast të tingëllojë këmbana e kryengritjës kombëtare në Shqipërinë tonë, sepse deshirojmë të derdhim edhe pikën e fundit të gjakut për të mirën e atdheut tonë të dashur“. Një lexues tjetër: „...më lejoni t'ju them se unë ndjek me padurim revistën tuaj, në të cilën shoh t'ardhmen e Shqipërisë... Unë shpreh ndjenjat e mia, të një ushtari kyengritës shqiptar dhe jam i gatshëm të jap provat e mia për këto ndjenja“. Të tjerë lexues e konsideronin De Radën „burrin më të ndritshëm, meqë atij s'duhej t'i flisje gjë tjetër veçse për Shqipërinë“. De Rada ua bëri të qartë të gjithë armiqve të Shqipërisë se „në brigjet lindore t'Adriatikut çështja shqiptare ka marrë rrugën e vet“. Me këto fjalë tribuni me gjithë rrethanat tepër të vështira shprehte optimizmin e vet për të ardhmen e kombit. Me artikujt e njëpasnjëshëm i sulmoi si pushtuesit osman ashtu edhe fqinjët shovinistë, të cilët synonin t'i kapërdinin trojet shqiptare, pa i lënë anash as padronët e tyre bashkë me aleancat që i thurnin në fshehtësi. Ndër të tjera ai theksonte se „Idea e parë e federatës ballkanke lindi në mendjen gënjeshtare të Greqisë. Këtë ide e përkrahin edhe të përkohshmet e Italisë. Zemrat tona janë të helmuara shumë nga një qëndrim kaq armiqësor. Qëndrim të prerë De Rada mbante si ndaj Italisë ashtu edhe ndaj Austrisë: „... Shfaqet dhe shkon gjithnjë duke u shfaqur një dëshirë e sapo shprehur, që të vihet këmbë në bregdetin e Shqipërisë dhe një frigë se shpejt Austria do të zbresë në ato brigje dhe do t'i zërë diellin Italisë. Tribuni s'e kurseu asnjëherë fqinjin përtej Adriatikut; „... përkundrazi, sa herë që u dukej se po shpërthente zjarr, apo dilte tym në Lindje, ata u uronin sukses Greqisë, Serbisë e Malit të zi që kërkonin të coptonin Shqipërinë“.

Me ashpërsi të pashoqe De Rada u vërsulet Fuqive të Mëdha europiane e sidomos Ruisë dhe rodit të saj në Ballkan, duke mbështetur njëkohësisht edhe optimizmin e jashtëzakonshëm si Naimi dhe rilindasit tjerë të shquar në fitoren e popullit shqiptar; „Në çdo rast Shqipëria e strukur në vetvete dhe e mbledhur në degët e saj të shpërndara do të jetë shkëmb në të cilin do të thyhen tallazet sllave. Klyshtë e Ruisë, Mali i zi me Serbinë e tij të vjetër lakmojnë t'i bien për emrit tonë. Dhe kudo qofshin, Panrusët, janë të lidhur në mënyrë

të fshehtë me Greqinë, duke bërë plane e projekte për të na shuar“. Fakte për këtë „akuzë iracionale“?! Sa të duash, Prandaj togfjalëshin e gozhdova në thonjëza se: mos nuk ishin inaguruar dyzet vjet para se të fliste De Rada dy projektet më antishqiptare „Naçertania“ dhe „Megali Idea“, të cilat, fqinjët shovenistë, herë me veprime vetanake e herë të sinkronizuara, u përpoqën t'i realizojnë edhe me terror përmasash gjenocidale, nëpër dekadat e një shekulli të tërë? Pra, se mos ka ndonjë që s'e di se Greqia e Serbia e donin për kufi të tyre lumin Shkumbin! Se mos nuk i priu tavolinës së Berlinit terrori gjenocidal serb i nxitur edhe nga Rusia, në trojet shqiptare nga Nishi e deri në kufijtë e Kosovës së sotme?!

Ndaj atyre mizorive me bajonetë e pendë poeti i madh nuk mund të mos rrebelohej nëpër faqet e „Fjamurit ...“ Përveçse i denoi pa mëshirë si një tribun i njëmendët, De Rada mori guximin edhe t'i parashikojë pa kurrëfarë dorashkash armiqtë „standard“ që në vazhdimësi do të përpiqen për t'i gëlltitur trojet shqiptare. Fatkeqësisht ato parashikime ia verifikoi katërçiprisht i tërë shekulli XX kur tashmë poeti ishte në përjetësi. Se mos nuk ia vunë zjarrin trojeve shqiptare sllavë e grekë nga Veriu në Jug, nga Lindja në Perëndim para e pas 28 Nëntorit të vitit 1912, për t'i masakruar pastaj edhe me bojë në Londrën e '13-tës! Dihet, leva e tyre ishte Rusia cariste. Edhe tavolina e Parisit e 19-20'tës ishte mjaft e begatshme me projekte për copëtimin e trojeve shqiptare. Ndër ta duhet përmendur ai i Londrës së pesëmbëdhjetës (Historia e popullit shqiptar III f. 129).

Po tavolinës së Parisit një çerek shekulli pas të parës çka i parapriu? Shovenistët grekë e zbrazën me zjarr e hekur Çamërinë nga popullsia e saj etnike. Edhe pas këtij preludi se i dukej i paktë kërkonte të arrijë deri në Vjosë. E në anën tjetër, pas tavolinës së Parisit në 46-tën, Jugosllavia titiste gati në një të dytën e trojeve shqiptare vrau e shpërnguli qindra e mijëra shqiptarë gjatë një gjysëm shekulli, megjithatë, ato mbetën çfarë edhe ishin - shqiptare. Më në fund, i erdhi radha që edhe kështjella e „Rambujesë“ në saje të luftës së popullit shqiptar për çlirimin e vendit, nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës hyri në analet e historisë shqiptare dhe të diplomacisë botrore. Aty u shtrua çështja e Kosovës dhe e ardhmja e saj. Dekada pas „Rambujesë“ mendoj se nuk i përket natyrës së këtij punimi.

Me „Fjamurin e Arbërit“, e cila konsiderohet si tribuna më e

rëndësishme e atyre viteve, bashkëpunuan rilindasit e të dy anëve të Adriatikut: Santori e Skiroi, Dara e Markiano, Naimi e Samiu, Vretoja me Mitkon e të tjerë. E çmuan lart dhe bashkëpunuan me revistën edhe shumë dijetarë të huaj, fushash nga më të ndryshmet: si Majeri e Tomazeu, Knor e Buholz, De Simone e të tjerë. Sa për Elena Gjiken të mos flasim se dihet. Përveç emrave të shquar, disa nga të cilët u çekën më lart, „Fjamurin“ e çmuan edhe redaksitë e revistave të njohura europiane siç ishte „Melusine“ e Parisit dhe „Die Presse“ e Vjenës. Derisa e para e quante si një organ të parë të Shqipërisë së mirëfillt, e dyta theksonte se „Kjo e përkohshme është një shenjë e përparimit në këtë vend malor - Shqipëri në të cilën historia fillon në kohët më të lashta prehistorike në mos me mitet“. De Rada pas katër vjetësh e ndërpreu botimin e „Fjamurit“ për të njëjtat shkaqe që e detyruan të veptoi edhe me „L'Albanesse ...“ para 39 vjetësh. Pezmin e thellë e shprehi poeti dhe tribuni në një letër dërguar mikut dhe albanologut të shquar G. Majer në të cilën ndër të tjera ia kujtoi thënien e famshme të Gëtes se „...Kush don ta shoh mjerimin, le të shkoj në Itali“ (J. K. Vep e cit. f. 268 e në vazhdim). Me këtë akt De Rada e mbylli me lavdi veprimtarinë e vet duke vënë gurë të parë në themelin e publicistikës shqiptare.

PËRFUNDIM

Së pari, dua ta përsëris edhe njëherë atë që është thënë më lart se rreth ndonjë veprë letrare, më pak të rëndësishme, apo edhe të ndonjë tjetre që i përket ndonjë zhanri tjetër, nuk u ndala për arsye të natyrës së këtij shkrimi. Megjithatë, nuk mund të kapërcehet „Testamenti politik“, veprë kjo të cilën ndonjë studiues e ka pagëzuar si dhjatën që arbëreshi i lavdishëm ia linte kombit vetëm pak muaj para se të shkonte në përjetësi. Se është e atyre përmasave dëshmon jo vetëm titulli po edhe përmbajtja e saj, të cilës këtu do t'i referohem vetëm në kornizën e këtij induksioni në cilësinë e portretizimit të figurës së jashtëzakonshme të De Radës dhe vendit që ai zë në historinë e kombit dhe të kulturës së tij. Derisa me përpjekjet për një alfabet të ri e të përbashkët për të gjithë shqiptarët ishte bashkudhëtar i Veqilharxhit, De Rada ishte prijës në këto fusha të kulturës kombëtare:

1. Me veprën e tij poetike, veçoria kryesore e së cilës ishte tabani i saj thellësisht kombëtar, është themeluesi i letërsisë së re shqipe;

2. Me frymën krejtësisht romantike që e karakterizon poezinë e tij, ai është njëkohësisht edhe bardi i romantizmit në letërsinë tonë;
3. Është i pari që Kryeheroin e shqiptarëve dhe epokën e tij e pasqyroi në ato përmasa që në poezinë shqipe nuk u përserit më;
4. Me të përditshmën dhe të përkohshmen që sapo u trajtuan, De Rada është themeluesi i publicistikës shqiptare;
5. Është i pari studiues shqiptar që e shkroi një gramatikë të gjuhës shqipe;
6. Është, gjithashtu, i pari poet e studiues shqiptar që e shkroi një traktat nga fusha e estetikës;
7. Me botimin e veprës „Rapsodi të një poeme shqiptare“ është themeluesi i folkloristikës;
8. De Rada është i pari mësues i gjuhës shqipe në historinë e arësimit kombëtar.

Ndërkaq, ai nuk ishte gjithkund i pari shtegtar. Në fushën e gjuhësisë, siç u tha atje ku duhej, pati pararendës. Megjithatë, De Rada ishte njëri nga më të shquarit. Prejardhja e shqipatrëve dhe e gjuhës së tyre ishte tema e preokupimeve të jetës së tij. Mendimin se pellazgët ishin stërgjyshërit e kombit tonë, përveç se në atë vistër punimesh, e mbrojti edhe në „Testamenti politik“. Në këtë vepër përveç saj dhe të tjerave, De Rada e pasqyroi tërë veprimtarinë e Levizjës Kombëtare Shqiptare në shekullin XIX. Natyrisht se aty ka gjetur vendin e vet edhe veprimtaria e tij. Në këtë vepër De Rada, së pari, shpreh besimin e palëkundur se kombi shqiptar do ta fitojë lirinë. Ndërkaq, për të atdheun e tij e përbënin të katër vilajetet „... të cilat të njësuara e të bashkërenditura, do ta ripëtërijnë“. Aty përsëritet akuza dhe dënimi që ua shqiptoi në artikujt publicistikë si fqinjëve shovinistë ashtu edhe Fuqive të mëdha. Askush nuk të ndihmon, porosit titani arbëresh, nëse nuk sheh aty interesin e vet. Këtë aksiomë, siç u tha edhe më lart e dëshmoi tërë shekulli XX.

Në mbrojtje të prejardhjes së shqipatarëve nga pellazgët De Rada nuk ishte i vetmuar. Pikëpamje të tilla kishte atëherë edhe ndonjë dijetar i metropoleve europiane. Por, shumica e studiuesve nuk e gjejnë të mbështetur, sepse mungojnë shumë të dhëna për atë popull të lashtë. Përveç të tjerave, s'ka asnjë dëshmi të mirëfilltë për gjuhën e tyre, si një nga treguesit kryesor i identitetit të çdo populli. Megjithatë, edhe një shekull pas De Radës çështja pellazge është në tavolinën shkencore të studiuesve shqiptarë e të huaj (shih: Sh, Demiraj

„Prejardhja e shiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe“, Tiranë, 1999 dhe „Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët“, Tiranë, 2008). Shikuar nga ky kënd mundi dhe pikëpamja e rilindësit arbëresh nuk rezulton të jetë farë herezie shkencore. Përkundrazi, mund të konsiderohet një farë satisfaksioni për të. Në anën tjetër, mendimin e De Radës se gjuha shqipe nuk është e afërt me greqishten në atë shkallë sa të quhej binjake me të qysh mendonte Kamarda, gjuhësia shqiptare e gjeti të saktë bashkë me konstatimin tjetër se greqishtja përveçse i ka dhënë shqipes një numër të konsiderueshëm fjalësh, ajo edhe ka marrë prej saj.

Nga këto që u thanë deri këtu mund të shtrohet pyetja: i ka De Rada përmasat e një figure europiane dhe nëse po, me cilat nga fushat e numëruara më sipër duke i përfshirë edhe këto të fundit? Përgjigjja është: Po - me shkronjë të madhe. Së pari, me poemat e tij letërsinë ose më sakt poezinë shqipe e bëri mesë paku pjesë të asaj europiane. Në anën tjetër, ajo vistër punimesh të karakterit historiko - gjuhësor, me gjithë mungesat që i karakterizojnë, dhe pjesëmarrja e tij Në kongresin e XII Ndërkombëtar të orientalistëve që u mbajt në tetorin e vitit 1899 në Romë ku ai lexoi kumtesën „Tiparet e gjuhës shqipe dhe monumentet e saj në periudhën parahistorike“, janë disa nga provat që dëshmojnë katërçipërisht se edhe në fushën e gjuhësisë ai e kishte arritur, së paku, „koeficientin“ e një dijetari përmasash europiane. Këtyre mund t'ju shtohen edhe konsideratat e disa studiuesve të shquar për mes të cilave ata shprehin vlerësimet për veprën shkencore të De Radës. Dëshmojnë gjithashtu, në këtë drejtim edhe veprat e tij të përkthyer përveçse në italishte edhe frengjisht gjermanisht.

Nuk është kurrfarë risie nëse theksojmë se nga gjysma e shekullit XIX e deri në Shpalljen e Pavarësisë veprimtaria letrare arsimore publicistike e shkencore kishte njëkohësisht edhe karakter politik respektivisht kombëtar. Sepse, siç u citua më lart „Liria nuk mund të vinte vetëm nga gryka e pushkës...“ Prandaj, demiurgët e këtyre fushave janë njëkohësisht edhe protagonistë të historisë shqiptare. E, De Rada ishte nga më të shquarit deri në çastet e fundit të jetës. Prandaj „përveç autorit të atyre vargjeve, është titani arbëresh në radhë të parë ai që „Fjalët e qiririt“ mund t'i blatohej si kurorë lavdie. Ai ishte Apostulli i shqipatizimit në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale.

LITERATURA:

1. E. Çabej: *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë, 2006
2. Grup autorësh: *Historia e popullit shqiptar II*, Tiranë, 2002
3. Dh. S. Shuteriqi: *Segoni, De Rada ... Noli*, Tiranë, 1987
4. J. Kastrati: *Historia e gramatologjisë shqiptare*, Prishtinë, 1980
5. R. Qosja: *Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi II*, Prishtinë, 1984
6. *Fjalori Enciklopedik shqiptar*, Tiranë, 1985
7. Ismail Qemali, *Monografi, Koli Xoxi*, Tiranë, 1983
8. E. Çabej: *Meshari i Gjon Buzukut*, Tiranë, 1968
9. R. Qosja: *Semantika e ndryshimeve historiko-letrare*, Prishtinë, 2009
10. *Gramatika e gjuhës shqipe - Morfologjia*, Tiranë, 1995
11. T. Osmani: *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999
12. J. Kastrati: *Studime për De Radën New York*, 2003
13. *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990
14. S. Riza: *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë, 1994
15. A. Kostallari: „Mbi disa veçori strukturore ... „Në studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve, I, Tiranë 1972
16. I. Ajeti „E. Çabej dhe studimet e gjuhësisë shqiptare “Në gjurmime albanologjike, Prishtinë, 2009
17. R. Qosja: „Romantizmi dhe Lidhja shqiptare e Prizrenit “Në Konferenca shkencore për LSHP, Prishtinë, 1981
18. *Konferenca kombëtare e studimeve për LSHP*, Tiranë, 1979
19. A. Uçi: *Estetika e groteskut I*, Tiranë, 2001
20. K. Frashëri: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë, 1997
21. Sh. Demiraj: *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999
22. Sh. Demiraj: *Epiri, Pellazgër, Etruskët dhe Shqiptarët*, Tiranë, 2008.



© Pashtriku.org, Shkurt 2016